

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7801  
E premte, 31 maj 2024  
Çmimi 0.50 €

Gjykata Speciale  
ka prioritet politikën  
dhe jo drejtësinë | FAQE 6



Nga Sali BISLIMI

Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## AKTUALE



**PARLAMENTI SPANJOLL MIRATOI  
LIGJIN PËR AMNISTI PËR  
SEPARATISTËT KATALONAS** F. 2

**SHTATË TË ARRESTUAR  
NË RASTIN "ALBKINGS",  
MBYLLET PËRFUNDIMISHT GRUPI** F. 7

**MILAZIM KRASNIQI PUBLIKON  
NJË ARTIKULL TË VITIT 1999  
KUR LDK-JA I JEPTË MBËSHËTETJE  
TË FUQISHME UÇK-së** F. 3

## EKONOMI



**INVESTIMET NË EFIÇIENCË  
ENERGJETIKE, BERZH-I DHE  
DONATORËT NDIHMOJNË MBI  
18 000 EKONOMI FAMILJARE NË  
BALLKANIN PERËNDIMOR** F. 8

**MINISTRIA E FINANCAVE,  
PENSIONISTËVE: KUJDES  
NGA LAJMET E RREME  
PËR SKEMAT PENSIONALE** F. 8

## SPORT



**FODA: DUAM FITORE NDAJ  
NORVEGJISË** F. 10

# ÇFARË DUHET TË DINI PËR ZGJEDHJET PËR PARLAMENTIN E RI EVROPIAN?



Zgjedhjet për Parlamentin e ri Evropian do të mbahen në të gjitha 27 vendet anëtare të Bashkimit Evropian nga 6 deri

më 9 qershor. Rreth 370 milionë qytetarë kanë të drejtë vote në gjithë bllokun, por jo të gjithë do të dalin në zgjedhje. Sipas një

sondazhi të bërë së fundmi, rreth 71 për qind e të anketuarve synojnë të votojnë dhe kjo do të ishte një shifër tejte e mirë

**KURTI THA SE SHKON KUDO QË E THËRRASIN, REAGON JASHARAJ: KRYEMINISTËR, EJA NË JAVËN E ARDHSHE NË SBASHK** F. 3



**KDI-JA: LIPJANI, DRENASI, FERIZAJ DHE PRIZRENI, KOMUNAT MË TRANSPARENTE GJATË 2023-S** F. 7



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçishtë - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA** GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
INFO: 049-111-101, 044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) / [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Parlamenti spanjoll miratoi Ligjin për amnisti për separatistët katalonas

MADRID, 30 MAJ - Parlamenti i Spanjës i dha miratimin përfundimtar ligjit kundërthënës që amnistion qindra separatistë katalonas, që ishin përfshirë në përpjekjen për shkëputje të Katalonjës më 2017.

Ligji u mbështet nga qeveria e koalicionit të krahut të majtë të Spanjës, dy parti separatiste katalonase dhe parti të tjera të vogla politike. Ligji mori 177 vota për, ndërkaq 172 deputetë nga Partia konservatore Popullore dhe ajo e ekstremit të djathtë, Vox, votuan kundër.

Nga amnistia mund të përfitojë ish-presidenti i rajonit të Katalonjës, Carles Puigdemont, i cili u largua në Belgjikë pas një përpjekjeje të dështuar për shkëputjen e Katalonjës nga Spanja.

Nga ligji i ri mund të përfitojnë gjithashtu qindra njerëz të tjerë, duke përfshirë ish-zyrtarë të



Qeverisë rajonale të Barcelonës, qytetarë të thjeshtë që morën pjesë në protesta dhe oficerë policie që u përfshin në parandalimin e referendumit të paligjshëm për pavarësi që u mbajt nga Qeveria e Puigdemontit. Megjithatë,

miratimi i këtij ligji nuk nënkupton që problemet ligjore të separatistëve, që evokuan për pavarësi, do të zgjidhen menjëherë.

Ligji ka të ngjarë të përballet me sfida ligjore dhe të shqyrtohet nga gjykatat më të larta të cilat do ta

zbatojnë atë rast pas rasti.

Ka ekspertë që vënë në dyshim kushtetutshmërinë e tij, sepse thonë se ligji do të krijonte pabarazi mes qytetarëve spanjollë, duke favorizuar një grup.

Që nga marrja e pushtetit në vitin 2018, kryeministri spanjoll Pedro Sanchez është fokusuar në uljen e tensioneve në Katalonjën verilindore dhe ka argumentuar se amnistia është thelbësore për këtë proces. Megjithatë, amnistia ishte gjithashtu një domosdoshmëri politike për Sanchez, i cili pranoi ta miratonte faljen për separatistë, pasi kishte nevojë për mbështetjen e ligjvënësve separatistë për miratimin e qeverisë së re kombëtare në nëntor.

Ligji u miratua fillimisht nga Dhoma e Ulët e Parlamentit në mars.

Senati, në të cilin partitë e krahut të

djathtë kanë shumicën, në fillim të këtij muaji vendosi veto, por Dhoma e Ulët e shtyu përpara ligjin.

Edhe pse amnistia është një temë që ka mbështetje në Katalonjë, Partia Popullore dhe Vox kanë organizuar protesta kundër ligjit në Madrid dhe qytete të tjera në mbarë Spanjën.

Ndërkaq, kritikë të amnistisë ka edhe në partinë e kryeministrit Sanchez.

Referendumi i pavarësisë u shpall i paligjshëm nga gjykatat në Spanjë dhe rezultoi në krizën më të rëndë politike të Spanjës në dekada.

Kjo do të jetë amnistia më e madhe në Spanjë, që nga amnistia e përgjithshme - krimet e kryera gjatë diktaturës së Francisco Francos më 1977.

Ky është, gjithashtu, ligji i parë i amnistisë i miratuar në Bashkimin Evropian që nga viti 1991, sipas këshillit kërkimor spanjoll, CSIC.

## BE-ja paralajmëron vendosjen e FRONTEX-it në Serbi

BRUKSEL, 30 MAJ - Këshilli i Bashkimit Evropian (BE) ka dhënë dritën e gjelbër për nënshkrimin e një marrëveshjeje me Serbinë, e cila do ta mundësojë vendosjen e patrullave nga Agjencia Evropiane e Rojave Kufitare (FRONTEX) për kontrollin e kufijve, edhe brenda territorit të Serbisë në veprime të përbashkëta për kontrollimin e migrimit ilegal. Serbia ndodhet në të ashtuquajturën "Rrugë Ballkanike", e cila, pavarësisht prej rrethojave, kamerave të vëzhgimit dhe patrullave të përbashkëta kufitare, është rruga e dytë më aktive e migrantëve, sipas

raporteve të FRONTEX-it.

BE-ja ka njoftuar se Këshilli e ka miratuar këtë vendim të enjten në Bruksel. "Marrëveshja do t'u mundësojë BE-së dhe Serbisë të organizojnë operacione të përbashkëta që do ta përfshinin FRONTEX-in dhe gardën kufitare të Serbisë. Kjo, po ashtu, do të thotë se ekipet menaxhuese kufitare të FRONTEX-it mund të dislokohen në Serbi. Ato do t'i ndihmojnë Serbisë për t'i menaxhuar valët e migrimit, të veprorë kundër imigrimit të paligjshëm dhe të luftojë kundër krimeve tejkufitare", thuhet në njoftimin e Këshillit të BE-së.

BE-ja edhe deri më tash ka pasur

një marrëveshje bashkëpunimi me Serbinë për këtë çështje, por ajo mundësonte veprimet e FRONTEX-it vetëm në kufijtë e vendeve të BE-së me Serbinë. Marrëveshja e re do ta mundësojë vendosjen e FRONTEX-it brenda territorit të Serbisë.

FRONTEX është agjencia e BE-së përgjegjëse për zbatimin e menaxhimit të integruar evropian të kufijve, funksionimin efektiv të kontrollit kufitar në kufijtë e jashtëm të BE-së në koordinim me autoritetet kombëtare të shteteve anëtare të BE-së dhe vendeve të Shengenit (Islanda, Zvicra, Lihtenshtajni dhe Norvegjia).



## Katër të arrestuar gjatë operacionit evropian kundër krimit kibernetik



KIEV, 30 MAJ - Katër persona janë arrestuar në Ukrainë dhe Armeni dhe më shumë se 100 serverë në internet janë nxjerrë jashtë funksionit apo janë penguar gjatë një operacioni të madh që shënjestroi krimin ndërkombëtar kibernetik që ka prekur mijëra njerëz, tha Europol-i më 30 maj. Operacioni u krye në mes të 27 majit dhe 29 majit. Agjencia për zbatimin e ligjit e Bashkimit Evropian tha se ky ishte "operacioni më i madh kundër 'botnet-ëve', që kanë luajtur rol të madh në vendosjen e 'ransomware', apo softuerëve keqdashës, që kodojnë të dhënat.

Ndërkaq, termi 'botnet' përdoret për t'iu referuar një rrjeti të ndërlidhur kompjuterësh që hakerët përdorin për të përhapur viruse.

Ky operacion kundër krimit kibernetik u iniciua dhe u udhëhoq nga Franca, Gjermania dhe Holanda. Në operacion u përfshin disa shtete të tjera, përfshirë Shtetet e Bashkuara, Britania dhe Ukraina, tha Europol-i përmes një deklarate.

Ky operacion, sipas ministres së Brendshme të Gjermanisë, Nancy Faeser, ishte "goditja më e rëndësishme" deri më tani ndaj krimit kibernetik.

Gjatë operacionit, autoritetet kanë shkatërruar rrjetet përmes së cilave janë kryer sulme kibernetike në mbarë botën. Mijëra persona ishin viktimë nga ky krim kibernetik.

Një prej të dyshuarve kryesor, sipas autoriteteve, kishte përfituar të paktën 69 milionë euro në kriptovaluta, duke mundësuar përdorimin e infrastrukturës kriminale në internet për të kryer sulme kibernetike.

Europol tha se një prej personave të dyshuar u arrestua në Armeni dhe tre të tjerë në Ukrainë, duke shtuar se më shumë se 2.000 domene tani janë nën kontrollin e kësaj agjencie.



## Mbi 1 000 punëtorë shëndetësorë të Kosovës u punësuan në Gjermani për nëntë muaj

PRISHTINË, 30 MAJ - Mbi 1 000 punonjës shëndetësorë të Kosovës janë punësuar në Gjermani vetëm për nëntë muaj të vitit 2023. Instituti GAP ka publikuar të dhënat për numrin e të punësuarve në sektorin shëndetësor në Kosovë dhe

kosovarëve të punësuar në Gjermani, si mjekë, ndihmës mjekësorë etj. Në vitin 2019, sipas GAP-it, në Gjermani ishin të punësuar 5 440 kosovarë në Gjermani, kurse në Kosovë 14 582. Kurse në janar-shkurt 2023 në Gjermani ishin të punësuar si

punëtorë shëndetësorë 9 091 kosovarë. Në Kosovë ndërkohe ishin të regjistruar 14 786. Numri i të punësuarve në Kosovë që nga viti 2019 deri vitin e kaluar nuk ka ndryshuar shumë, megjithatë në Gjermani të dhënat tregojnë situatë tjetër.



## Gjykata Speciale ka prioritet politikën dhe jo drejtësinë



Nga Sali BISLIMI

Sjellja e gjykatës ndaj presidentit Thaçi duke ia vazhduar paraburgimin është edhe lojë me shtetin dhe popullin e Kosovës. Duke e bërë politikën dhe jo drejtësinë ajo shkel të drejtat e njeriut, dhe me këtë humb edhe kredibilitetin, por faji është edhe tek ne, ku janë ata burra të ashtuquajtur patriotë që nuk ngritën zërin për këtë formë të drejtësisë që është servuar Kosovës. Çka pret Parlamenti që nuk

debaton çështjen aq madhore të interesit të Kosovës, gjykatën që e ka formuar vet dhe kjo gjykatë abuzon dhe dëshiron ta kriminalizojë lirinë dhe Pavarësinë e Kosovës. Ku fle ndërgjegje e politikës së Kosovës pozitë-opozitë, apo presin që të hapin të pame në Parlament që me lot krokodili të reflektojnë dëmet që ky proces politiko-juridik ta godas Kosovën. Nuk ka virtyte pa përpjekje, nuk ka lumturi pa kurojë, pa sakrificë nuk do të ishim ku jemi. Kjo politikë qyqare pozitë dhe

opozitë është trashëgimi e të kaluarës së pushtimit serbo-turk, zor e ka ta ngrit kokën dhe të mbron interesat e Kosovës evropiane me forcën e civilizimit Perëndimor. Heshtja juaj është pajtim me politikën serbo-ruse ndaj Speciales. Lëshojni zërin more nëse ju ka mbet pak gjak i Gjergj Kastriotit, Adem Jasharit dhe Hashim Thaçit!

(Autori është drejtor i organizatës "Zëri Perëndimor i Kosovës" dhe drejtor i zyrës ligjore First-consulting.ch në Bern të Zvicrës)

## Kurti tha se shkon kudo që e thërrasin, reagon Jasharaj: Kryeministër, eja javën e ardhshme në SBASHK

PRISHTINË, 30 MAJ - Kryetari të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Rahman Jasharaj, duket se i kanë lënë përshtypje deklarata e kryeministrit Albin Kurti, i cili një ditë më parë, gjatë një tubimi në Prishtinë, për zgjedhjet në Luginë të Preshevës, tha se shkon aty ku e thërrasin.

Por të enjten kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, i cili e ka ftuar kryeministrin që javën e ardhshme ta vizitojë SBASHK-un. "E pata vështirë të besoj, prandaj e dëgjova disa herë. Pastaj, po ashtu, disa herë e lexova me kujdes dhe u binda se kryeministri paska thënë se shkon aty ku e thërrasin. Ky deklarim i tij më bëri ta kritikoj kryetarin e BSPK-së, Atdhe Hykolli, por edhe të bëhem vetëkritik. Ne i kemi dërguar dhjetëra kërkesa kryeministrit në emër të BSPK-së dhe shumë



kërkesa ministres Nagavci për takime e për të bashkëbiseduar për të gjitha shqetësimet dhe kërkesat e anëtarësisë, por u kemi thënë se takimet t'i mbajmë tej ata dhe meritojmë kritika se e paskemi harruar traditën shqiptare të mikpritjes dhe në shkresat tona për takime as edhe një herë nuk u kemi thënë ejani te ne. Tani kur

e mësova këtë dëshirë të kryeministrit dhe qeverisë së tij, se duhet t'i thërrasim, kafe dhe çaj kemi edhe ne. Publikisht po i drejtohem kryeministrit Kurti që ta marrë ministren Nagavci e ministrin Murati dhe të vijnë javën e ardhshme në SBASHK", ka thënë në deklaratën për medie Rahman Jasharaj.

## Milazim Krasniqi publikon një artikull të vitit 1999 kur LDK-ja i jepte mbështetje të fuqishme UÇK-së

PRISHTINË, 30 MAJ - Profesori universitar, një ndër themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Milazim Krasniqi, ka publikuar në llogarinë e vet në "Facebook" një artikull të gazetës së atëhershme "Rilindja Demokratike", ku shihet se LDK-ja në vitin 1999 i jepte mbështetje UÇK-së. "Pas takimit të përfaqësive sonë të LDK-së me Jakup Krasniqin në Tiranë më 30

prill 1999 në shtëpinë e Meriman Brahës, ku ishte edhe Bilall Sherifi dhe pas takimit me kryesinë e PDSH-së po atë ditë, ne kemi afirmuar këtë qëndrim të LDK-së, që shihet në këtë titull të gazetës RD. Ftesa për unitet dhe për luftë të përbashkët ka qenë kulminacioni i atij angazhimi, për të cilin gjithmonë do të jam i lumtur", ka shkruar Krasniqi.



## Delfin Pllana emërohet ambasador i Kosovës në Hungari

PRISHTINË, 30 MAJ - Delfin Pllana është emëruar ambasador i Republikës së Kosovës në Hungari. Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, në "X" ka shkruar se ambasadori Pllana do të

vazhdojë t'i forcojë lidhjet midis dy vendeve. "I shpreh urimet e mia më të mira ambasadorit të emëruar Delfin Pllana, ndërsa ai merr detyrën e re si ambasador i Republikës së

Kosovës në Hungari. Unë jam i bindur se ai do të vazhdojë të forcojë lidhjet midis vendeve tona dhe të thellojë lidhjet midis popujve tanë", ka shkruar Osmani.







# Çfarë duhet të dini për zgjedhjet për Parlamentin e ri Evropian?

**BRUKSEL, 30 MAJ** - Zgjedhjet për Parlamentin e ri Evropian do të mbahen në të gjitha 27 vendet anëtare të Bashkimit Evropian nga 6 deri më 9 qershor. Rreth 370 milionë qytetarë kanë të drejtë vote në gjithë bllokun, por jo të gjithë do të dalin në zgjedhje.

Sipas një sondazhi së fundmi, rreth 71 për qind e të anketuarve synojnë të votojnë dhe kjo do të ishte një shifër tejet e mirë. Në zgjedhjet e kaluara, më 2019, dalja në zgjedhje në gjithë BE-në ishte 50.7 për qind.

Kjo shifër vlerësohej si e mirë, sepse ishte hera e parë që numri ishte rritur prej se zgjedhjet e drejtpërdrejta për Parlament filluan të mbahen më 1979, duke i dhënë fund një trendi të rënies së vazhdueshme të përqindjes së daljes në zgjedhje.

Natyrisht, dalja në zgjedhje ndryshon shumë nga vendi në vend. Në Belgjikë dhe në Luksemburg, ku hedhja e votës është e detyrueshme, dalja në zgjedhje ishte gati 90 për qind para pesë vjetëve, ndërsa në Republikën e Çekisë

ishte vetëm 28 për qind dhe në Sllovakinë fqinje vetëm 22 për qind.

## Për çfarë do të votojnë njerëzit në të vërtetë?

Qytetarët e BE-së do t'i zgjedhin 720 anëtarë të Parlamentit nga të gjitha vendet anëtare, bazuar kryesisht në madhësinë e popullsisë së secilit vend. Pra, Gjermania do të dërgojë më së shumti ligjvënës në Bruksel/Strasburg - 96 eurodeputetë - ndërsa Qiproja, Luksemburgu dhe Malta nga 6 sosh secila.

Demokracia evropiane është paksa e çuditshme, dhe ndër çuditirat e saj është se nuk e ka një "popull" evropian por 27 - që nënkupton se, derisa zgjedhjet quhet evropiane, në to garojnë partitë politike nacionale si, për shembull, social-demokratët në Gjermani (SPD), apo partia konservatore spanjolle Partido Popular (PP). Por, sapo eurodeputetët të emërohen nga listat nacionale, ata kanë prirje të bëhen pjesë e

grupeve, apo familje politike trans-evropiane.

Në Parlamentin e mandatit 2019-2024 kishte shtatë grupe të tilla, të cilat duhet të përbëhen nga së paku 23 eurodeputetë nga të paktën shtatë vende të BE-së. Pritet që këto grupe të mbesin, por nuk mund të hidhet poshtë mundësia e krijimit të grupeve të reja. Lufta për eurodeputetë nga të gjitha anët ka filluar tashmë dhe vetëm sa do të rritet.

## Cilat janë grupet politike?

Grupi më i madh politik është ai i qendrës së djathtë, Partia e Popullit Evropian (EPP) - pjesë e së cilës janë CDU-ja gjermane dhe Platforma Civile polake (PO) - i ndjekur nga Socialistët dhe Demokratët (S&D) - që sjell së bashku partitë socialdemokrate të qendrës së majtë. Pastaj ka shumë grupe të tjera, duke nisur me Renew, i cili mbledh partitë liberale dhe ato të qendrës, siç është Partia Renaissance e presidentit francez, Emmanuel Macron.

Pastaj është grupi i të Gjelbërve, ku bëjnë pjesë partitë e gjelbra dhe ato ekologjike, por edhe partitë pirate dhe separatistët katalanas. Grupi GUE/NGL grumbullon partitë komuniste dhe të ekstremit të majtë, ndërsa në anën tjetër të spektrit ideologjik janë Reformistët dhe Konservatorët Evropianë (ECR), të cilët vlerësohen nga disa si nacionalistë.

Një grup tjetër përbëhet nga partia çeke ODS, partia polake Ligj dhe Drejtësi (PiS), Demokratët Suedezë, Partia Finlandezët dhe partia e kryeministres italiane, Giorgia Meloni, Vëllezërit e Italisë. Dhe në fund është grupi Identiteti dhe Demokracia (ID), i cili ka anëtarë si partia e Marine Le Penit Lëvizja Nacionale, Partia e Lirisë e Austrisë (FPO) dhe Liga (Lega) e Matteo Salvinit. Ka edhe një numër partish pa grupe, të cilët shpesh ishin pjesë e ndonjërit prej grupeve, por u dëbuan dhe nuk kanë gjetur ende grup të ri. Ndër ta është partia Fidesz e Viktor Orbanit, e përjashtuar nga grupi EPP më 2021, apo

Smeri i Robert Ficos, që u përjashtua nga S&D vitin e kaluar.

## Pse kanë rëndësi grupet politike?

Nuk duhet të shpërfillet rëndësia e grupeve politike në Bruksel. Ato janë sikur një familje e mirëfilltë, sepse kujdesen për anëtarët e vet dhe i promovojnë ata kurdo që u jepet mundësia.

Sa më e madhe që është familja, aq më shumë kohë fiton për të folur në Parlament. Mundësitë janë gjithashtu më të mëdha për ta siguruar postin e kryetarit të një komiteti me ndikim, postin e presidentit apo zëvendës-presidentëve të Parlamentit.

Sa ma i madh që të jetë grup, aq ma të mëdha do të jenë shanset që ndryshimi i një ligji të mbështetet, apo që raporti i grupit tuaj do të gëzojë mbështetje për t'u miratuar. Duke mos qenë pjesë e një grupi, ndikimi juaj është zero. Në këtë Parlament sundojnë familjet.



## Pra, kush fiton?

Askush, në të vërtetë. Politikat evropiane kanë të bëjnë me ndërtimin e koalicioneve, në fund të fundit. Sipas të gjitha gjasave, EPP-ja do të dalë e para përsëri, siç ka bërë në çdo palë zgjedhje për Parlament Evropian prej vitit 1999. Sondazhet sugjerojnë se ajo do t'i fitojë rreth 170 ulëse në Parlamentin e ri, që është më pak se para pesë vjetëve, dhe shumë më pak se në të kaluarën kur fitonte rregullisht nga 200 ulëse. S&D-ja me gjasë do të përfundojë e dyta, sikur në të kaluarën, me rreth 140 ulëse, njëlloj si më 2019. Pesë grupet e tjera parashikohet të fitojnë nga 30 deri në 80 ulëse secili. Duket se Renew dhe të Gjellbrit do të humbin ulëse, krahasuar me pesë vjet më parë, ndërsa ECR-ja do të fitojë më shumë. Por mund të ketë mbi 100 eurodeputetë që deri tani nuk janë pjesë e asnjë grupi, apo familjeje politike. Shumica e tyre do të jenë populistë, prandaj ka gjasë që të bëhen pjesë e ID-së apo ECR-së, apo të ndonjë grupi tjetër të djathtë që do të formohet.

## Populistët e djathtë fitues të mëdhenj?

Po dhe jo. Nëse llogarisim ulëset e projektuara për ID-në, ECR-në dhe deputetët pa grupe, të cilët me gjasë do të jenë djathtë gjithashtu, dhe

e shtojmë EPP-në e qendrës së djathtë, atëherë kemi 400 ulëse, pra një shumicë. Ama prisni. EPP-ja është, para së gjithash, shumë e zakonshme me një brez federalist në Parlamentin Evropian.

Është përfolur me vite për një supergrup euroskeptik, por deri tani nuk ka ndodhur asnjëherë, dhe nuk ka gjasë të ndodhë as tani. Pse? Është e pamundur ta zgjidhesh problemin e të qenët nacionalist në nivel evropian. Prandaj, shumë të ashtuquajtur populistë ndahen në dy grupe, ECR dhe ID, dhe mbase do ta krijojnë edhe të tretin. Ata mund të pajtohen se Brukseli duhet të ketë më pak pushtet.

Fakti që Fidesz është ende pa familje pas tri vjetëve e dëshmon këtë, por asgjë nuk i pasqyron më mirë ndarjet mes djathtësive sesa lajmi i fillim majit, kur AfD-ja gjermane u përjashtua nga grupi ID, pasi njëri prej liderëve të saj tha në një intervistë se jo çdo anëtar i njësitit nazist SS gjatë Rajhut të Tretë “është automatikisht kriminel”.

Vendimi për përjashtimin e tyre u nxit nga Marine Le Pen, e cila ka vite që përpiqet ta zbusë imazhin e vet dhe të partisë, pasi ka thashetheme se ajo mund të kërkojë t'i bashkohet ECR-së në të ardhmen.

Ka thashetheme gjithashtu se Giorgia Meloni, ardhja e së cilës në pushtet vite më parë nxit frikë nga disa se Italia mund të flirtojë më fashizmin, do të tentojë ta zbusë imazhin edhe më shumë duke e

bashkuar partinë e vet Vëllezërit e Italisë me EPP-në. Prandaj, “ngritja e djathtësive” mund të jetë thjesht histeri mediatike.

## A do të ketë ndikim në politikat e BE-së?

Këtu lind edhe një çudi tjetër evropiane: Parlamenti Evropian nuk është sikur parlamentet e zakonshme nacionale të zgjedhura në mënyrë demokratike, në kuptim se eurodeputetët nuk propozojnë ligje vetë.

Në BE, është Komisioni Evropian ai që gëzon të drejtën për nisma dhe e fillon përpilimin fillestar të një ligji të mundshëm të ri. Parlamenti Evropian bëhet pastaj bashkëlegjislator me Këshillin, në të cilin përfaqësohen vendet anëtare, që nënkupton se ato e rregullojnë ligjin e propozuar, shpesh duke bërë pazare me Komisionin dhe Këshillin për muaj apo vite, para se të arrijnë pajtueshmëri dhe ta bëjnë atë ligj në tërë bllokun. Parlamenti Evropian është më i dobëti në mesin e këtyre tri institucioneve.

## Pse duhet ta çaj kokën për zgjedhjet për Parlamentin Evropian atëherë?

Epo, këtu bëhet vërtet interesant! Parlamenti Evropian po përpiqet fort të bëhet i rëndësishëm për votuesin mesatar evropian.

Në disa mënyra, edhe ia ka

dalë mbarë. Merreni shembullin e kandidatit kryesor – i njohur në Bruksel me emrin gjerman Spitzenkandidat. Kjo ishte bërë për zgjedhjet për Parlament Evropian më 2014 dhe funksionin kështu: Grupet politike e nominonin një person dhe nëse grupi politik del i pari në zgjedhje, atëherë personi i tij nominohet për postin e rëndësishëm të presidentit të Komisionit Evropian.

Më herët, për atë pozitë, si dhe për pozitën e presidentit të Këshillit Evropian dhe shefit të BE-së për politikë të jashtme, vendosnin liderët e 27 vendeve anëtare të BE-së përmes marrëveshjeve të fshehta në Bruksel, duke i marrë parasysht jo vetëm lidhjet partiake, por edhe gjininë dhe gjeografinë. Në thelb, tri pozitën duhet të ziheshin nga burra dhe gra, për ta pasqyruar baraspeshën verijug, lindje-perëndim të bllokut, me tri partitë më të mëdha politike, normalisht EPP-së, S&D-së dhe Renew-s që merrnin nga një pozitë secila. Këtë vit, Ursula Von der Leyen po kërkon të rizgjidhet presidente e Komisionit Evropian dhe është kandidate kryesore nga EPP-ja, e cila, siç u përmend më lart, pritet të dalë e para në zgjedhje.

## Çfarë ndikimi mund të ketë Parlamenti Evropian në politikat e jashtme të BE-së?

Nëse je qytetar i BE-së, duhet

të të interesojë Parlamenti Evropian. Ai mund të mos jetë institucioni më i fuqishëm në Bruksel, por është me ndikim, sepse është bashkëlegjislator në politika të rëndësishme si, energjia, transporti, mjedisi dhe mbrojtja e konsumatorit.

Disa eurodeputetë gjithashtu i përmirësojnë aftësitë e tyre në Parlament për t'u bërë më vonë ministra të nivelit të lartë në vendet e tyre përkatëse, ndërsa ish-liderëve u pëlqen të përfundojnë në Parlamentin Evropian, prandaj ai është diçka që ia vlen ta ndjekësh. Por nëse nuk jeni qytetar i BE-së dhe vret mendjen për rolin që Parlamenti Evropian luan në botën e gjerë, atëherë duhet ta dish këtë: Parlamenti Evropian nuk i drejton politikat e jashtme të BE-së.

Politikat e jashtme të BE-së dhe ato për zgjerim janë vetëm në dorën e shteteve anëtare të bllokut dhe askujt tjetër. Parlamenti Evropian nuk pyetet për politikat për sanksionet. Derisa e ka votën përfundimtare për ta pranuar një shtet të ri anëtar, Parlamenti nuk pyetet fare për asnjë prej hapave paraprak: dhënie e statusit të vendit kandidat, vendimin për nisjen e bisedimeve, hapjen dhe mbylljen e mbi 30 kapitujve të pranimit.

Për më tepër, Parlamenti Evropian ka prirje të jetë gjithmonë për pranimin e një vendi, prandaj vota është gjithmonë vendim i ditur.

/REL/

# Me profilin e pëllumbit të bardhë e shqiponjën dykrenare, çfarë përfaqëson logoja në 25-vjetorin e çlirimit të Kosovës



PRISHTINË, 30 MAJ - Ministria e Kulturës ka publikuar logon dhe ka shpалosur agjendën shtetërore për shënimin e 25-vjetorit të çlirimit të Kosovës.

Aktivitetet për shënimin e 25-vjetorit të çlirimit të Kosovës nisin nga data 8 deri më 21 qershor. E se çfarë përfaqëson kjo logo, ka shkruar të enjten në

“Facebook” kryeministri Albin Kurti. “Frymëzuar nga historia dhe kultura, motivet e ngjyrat që i gjejmë të qëndisura në veshjet tradicionale e të thurura në

artizanatet tona, na vijnë të rifreskuara me dizajn modern. Aty shohim profilin e pëllumbit të bardhë që simbolizon paqen e lirinë, si dhe simbolin e

shqiponjës dykrenare e vigjilente, që është e ngulitur thellë në historinë e identitetin tonë kombëtar”, ka shkruar Kurti.





# Ali Ajeti - vigjilenti liridashës (2)

## Pjesëmarja në demonstratën e 30 majit 1989 në Podujevë (Në 35-vjetorin e rënies heroike)

**Basrie MURATI-SAKIRI**

Në mbrëmjen e 29 majit 1989, me t'u errësuar, papritmas erdhi Sabri Kijçmari aty ku isha e strehuar. Te familja e Fexhrie Poterës, bashkëveprimtare dhe bashkëfshatare e imja, e cila ishte arratisur në shtatorin e 1988-tës në Suedi, po ashtu për shkak të veprimtarisë atdhetare, isha vendosur disa ditë përpara. Në fytyrën e Sabriut dallohej qartë një shqetësim, dhe me vete mendova, se ardhja e tij kishte të bënte me diçka serioze. Dhe ashtu ishte - të nesërmen, pra më 30 maj 1989, do të zhvilloheshin demonstrata në Podujevë dhe në qytetet tjera të Kosovës. Po atë ditë vinte një delegacion i Parlamentit Evropian për ta vlerësuar situatën në Kosovë. Prandaj, edhe ne duhej të dilnim të demonstronim e t'u tregonim pakënaqësinë tonë, edhe pse ishim ilegalë. Rrezikun nuk e paramendova aty për aty, se nuk kisha kohë të kujtohesh. Më duhej të përgatitesha për të shkuar, sepse ai nuk priste.

Prej aty u nisëm diku pas orës 22:00. Për ku, ende nuk e dija. Për shkaqe rreziku e konspiracioni nuk tregohesh vendi se ku shkonim, derisa arrinim te vendstrehimi. Me kujdes arritëm të dilnim te hekurudha, jashtë lagjeve të qytetit. Edhe pse udhëtonim skaj hekurudhës, siguri nuk kishte. Policët ishin bërë si të tërbuar dhe flitej se mund t'i hasje kudo, prandaj në çdo hap na kanosej rreziku.

Te baza e paraparë arritëm pa problem. Ajo ishte shtëpia e bacë Ademit dhe gjendej në periferi të qytetit Podujevë, në një lagje të dendur. Ishte qetësi e madhe, vetëm të lehura qensh dëgjoheshin nganjëherë. Brenda në oborr hymë ngadalë nga ana e kundërt e shtëpisë, pa bërë as më të voglën zhurmë. Shkuam nga ana e kundërt e shtëpisë, ngase dyshohej se familja e Aliut përcillej gjithëherë nga ana e forcave policore. Një njeri pak i moshuar e me trup të plotë na e hapi derën dhe ashtu nëpër errësirë u futëm brenda. Ai kishte qenë bacë Adem, babai i Ali Ajetit. Aty na përshëndetën edhe dy të rinjë, që më vonë e kuptova se ishin vëllezërit e Aliut.

Pas një kohe, kanë ardhur edhe shokët tjerë, ku menjëherë filluam të përgatiteshim për demonstratë. Vendimi për demonstratë ishte marrë shumë shpejt dhe njerëzit nuk ishin të informuar sa duhet. Ne ishim të pasigurt, nëse do të kishte numër të duhur pjesëmarrësish. Nga ana tjetër, pjesëmarja jonë në demonstratë ishte me rrezik, sepse policia na kërkonte kudo që nga 27 marsi 1989 dhe ballafaqimi me ta, na priste luftë e hapur.

Parullat filluam t'i shkruajmë Aliut dhe unë. Ai i shkruante bukur me vizore në material stofi të bardhë

me ngjyrë të zezë, ndërsa unë pas tij i ngjyrosja me ngjyrë të kuqe. Gjatë punimit të tyre vendosëm të shkruajmë edhe parullën "Kosova Republikë!". Që nga demonstratat e vitit 1981 kjo parullë nuk ishte dukur nëpër tubime e demonstrata. Menjëherë më doli parasysh rreziku që na kanosej. Nga ana tjetër një shkëndijë gëzimi shkrepri në zemrën time. Në mesin e parullave tjera, që i shkruam atë natë, ishin: "Europë Help!", "Liri, Barazi, Demokraci!", "Më mirë vdekje, se robëri!", "Duam bukë!", etj... Jo vetëm për shkak të përmbajtjes, por edhe nga ana estetike, ato dukeshin bukur. Duke i punuar, bëmë shumë shaka me njeri-tjetrin e sidomos Sabriu me Aliun.

"Shqipe vetëm unë dhe ti kemi të drejtë ta quajmë veten punëtorë revolucionarë, këqyri këta dembelët veç rrinë e këqyrin seri!", më pati thënë Aliu me humor dhe mendohej ta fshehte buzëqeshjen në fytyrën e tij të çiltër.

Ndër të tjera, dikush tjetër pati pyetur se, nëse ndokush nga ne plagoset në demonstratë, çka duhej ndërmarë dhe si t'i ndihmojmë? Fjala ishte që t'mos biem të gjallë në duar të armikut. Aliu u përgjigj menjëherë:

"Me e vra, po çka? A po menon se po nalna e po e pres a? Me më vra edhe mua masanej!". Nga mënyra se si e tha ai ne përnjëherë ia nisëm të qeshim edhe pse flitej për diçka të vështirë!

"Unë nuk mund ta bëjë atë gjë!", tha Sabriu, kurse dikush nga grupi pas tij tha duke qeshur:

"Vallahi e bëj, që çka po vetë!". Dhe e qeshura vazhdoi edhe më tutje.

### Nëna e Aliut, nënë Vahidja, bënte roje

Në dhomën ku qëndruam atë natë na shoqëronte edhe bacë Adem, kurse nëna e Aliut, nënë Vahidja herë hynte e herë dilte, ngase na bënte roje. Ajo ishte një nënë shumë bujare dhe e ndjeshme. Kur ishte në praninë tonë na kënaqte me fjalët e saja, sa të dashura aq edhe të vendosura. Gjatë tregimeve të saja e vëreja edhe merakun që fshihte, se mos na priste ndonjë e ligë në demonstratë. Ishte me të vërtetë e vështirë ta mendoje rënien e ndonjërit prej atyre të rinjve. Të gjithë ishin përkushtuar, të matur e të ditur.

Nuk besoj të ketë vënë gjumë në sy atë natë ndonjëri prej nesh. Të nesërmen, pasi hëngrëm bukë (thënë të vërtetën vetëm sa morëm nga disa kafshore) filluam të bëheshim gati për të dalë në demonstratë. Të gjithë morëm veshmbathje të tjera për shkaqe kamuflimi/maskimi, disa të punëtorëve me ngjyrë të kaltër, e disa rroba nga vëllezërit e Aliut. Unë vetëm i shikoja. Aliu dikur më tha: "Po ty oj Shqipe, askush nuk po të sjell tesha tjera, a? (Shqipe ishte

pseudonimi, me të cilin më pagëzuan dhe më thërrisnin shokët në ilegalitet) Vetë shkoi e m'i solli nja dy palë pantallona e një xhemper.

"Në mos të ardh të mërzit që janë të miat, provoj a të biejnë e veshi qeto!", më tha. I vështa sikur të ishin të miat.

Pasi u përgatitëm mirë dolëm të shkonim në demonstratë. Një rrebesh shiu filloi, por nuk zgjati shumë. Ne u përshëndetëm me njeri-tjetrin, sepse nuk dihej se a do të takoheshim më. Nëna e Aliut ishte e fundit që na përshëndeti e përcolli jashtë oborrit të shtëpisë së bacë Ademit.

U nisëm me veturë të dilnim pas shkollës së gjimnazit "Isa Boletini" ku e kishim lënë në ora 12:00 të takoheshim me shokët të tjerë. Sapo dolëm nga vetura e vëllait të Aliut, në një rrugicë prapa gjimnazit, u takuam me shokët tjerë. Safet Ajeti, një shok i gjeneratës dhe ilegales, mbante në dorë një flamur të mbështjellë. Pak para se të dilnim në rrugën kryesore të qytetit, i ndamë transparentet. Atë me parullën "Kosova Republikë!" ma dha Aliu mua me një buzëqeshje vendosmërie. Ende e ruaj të freskët atë shkëlqim plot krenari, që shndriste fytyrën e tij. Qysh duke i shkruar parullat një natë më parë më pat premtuar, se do ta bënte një gjë të tillë. Ne ishim gati ta fillonim demonstratën.

Menjëherë pasi dolëm në rrugën kryesore që ishte e mbushur plot me nxënës, i kemi shpalosur transparentet dhe kemi filluar të bërtisim parullën "Kosova Republikë!". Të gjithë njerëzit që ishin kalimtar të rastit në rrugë i kanë drejtuar sytë nga ne, mirëpo nuk na afrohej njeri. Ata na vështronin me habi dhe në fillim nuk na u bashkëngjiti askush. Ne ishim veshur me rroba të pazakonshme dhe mbanim edhe kapelë në kokë, për t'mos u identifikuar nga policia. Duke brohoritur, kemi shkuar deri te qendra e qytetit. Tek atje na janë bashkangjitur nxënësit e gjeneratës time, shoqe dhe shokë që i njihja dhe disa të afërm tanë. Mirëpo, numri i tyre nuk ishte i mjaftueshëm, gjithsej në demonstratë nuk ishim as 150 vetë. Në qendër të qytetit ndeshëm disa grupe policësh, të cilët vetëm na shikonin pa ndërmarrë asgjë. Atë ditë thanë se kishin qenë policët sllovenë, prandaj edhe nuk na kishin sulmuar. Ne marshonim ballë për ballë tyre. Në ato momente nuk mërziteshim edhe pse mund të shtinin në ne. Shqetësoheshim dhe filluam të mllëfoseshim pse masa e njerëzve nuk na bashkohej, por vetëm na shikonte me habi. Vetëm më vonë e patëm kuptuar se shumica prej tyre ishin frikësuar për shkak të parullës "Kosova Republikë!" që brohoritej pas tetë vitesh dhe kishin dyshuar se nuk jemi shqiptarë, por provokatorë serbë.



### Përballë policëve të armatosur rënd

Të dytën herë, kur u kthyem te shkolla "Isa Boletini", kishin dalë shumica e profesorëve të na shikonin. Ne brohorisim pa ndërprerë parullat: "Kosova Republikë!", "Liri, barazi, demokraci!", "Republikë, kushtetutë, ja me hatër, ja me luftë!", e shumë parulla të tilla. Ashtu duke brohoritur, kemi shkuar në anën tjetër të qytetit deri te shkolla "8 Nëntori". Edhe atje nuk na është bashkangjitur masa rinore. Përkundrazi, kur na panë nxënësit ikën dhe hynë brenda në shkollë. Kjo na zhgënjeu shumë, sepse ne e patëm paramenduar ndryshe, që masa e nxënësve dhe e popullit do të na bashkëngjitej.

Përsëri morëm rrugën për në qytet, mirëpo sapo dolëm nga oborri i shkollës, hasëm në vështirësi. Ballë nesh, për afërsisht 100 metra larg, vinte një grup i zi policësh të armatosur rënd. Ne kemi marshuar drejt tyre, por nuk vonoi e na hodhën gaz lotsjellës. Ne filluam të shpërndaheshim, duke u tërhequr mbrapa dhe kemi vrapsuar sa më larg. Policia është vërsulur e tërbuar pas nesh. Në fund të oborrit të shkollës ishte një gardh prej teli të cilin e kërcyem me shumë vështirësi. Masa u shpërnda tërësisht. Një pjesë e demonstruesve iku drejt rrugës, e cila shpinte te pompa e benzinës, kurse pjesa tjetër nga ana jonë iku fushës në drejtim të fshatit Letanc. Policët u vërsulën pas atyre që ecnin

drejt rrugës në drejtim të Shtedimit, sepse ata e mbanin flamurin lart. Prej ilegalëve në anën tonë ndër të tjerë ishin edhe Shaban Mulolli e Ismet Abdullahu. Ne ecnim bashkë fushës dhe i shihnim nxënësit që vraponin arave në të gjitha anët. Bënte vapë, si të ishim në mes të verës edhe pse ishim ende në muajin maj.

Pas dy muajsh të jetës ilegale, dalja jonë hapur ishte e pabesueshme. Pasi që nuk shihnim ndonjë rrugëdalje, zumë vend afër një ferre, dhe u ulëm. Helikopterët e policisë dhe të ushtrisë silleshin mbi kokat tona dhe kishim frikë se mos na vërenin. Ashtu ulur, të fshehur nën kaçuba, skaj një are të mbjellë me misër e kanë pasur më vështirë të na dallonin. Ishte kohë e mihjes së misrit dhe nëpër ara kishte edhe fshatarë të tjerë që punonin. Nuk vonoi shumë dhe erdhën disa nga shokët dhe shoqet e gjeneratës sime, të cilët kishin frikë të ktheheshin në shkollë apo në shtëpitë e tyre, por pasi ne i këshilluan se si të vepronin, ata u nisën menjëherë. Qëndrimi me ne ishte i rrezikshëm. Pas një çasti që u vendosëm në atë skaj are, nga ana e Shtedimit u dëgjuan të shtëna automatiku. Shqetësimi ynë u shtua edhe më shumë dhe e ndjemë veten edhe më të pasigurt. Pothuaj dy orë zhurma e helikopterëve nuk pushoi. Ashtu me frikë dhe pasiguri qëndruam deri në përfundim të diellit. Nuk kishim asnjë rrugëdalje si të largoheshim nga aty dhe më e keqja nuk dinim asgjë se ç'kishte ngjarë me shokët dhe demonstruesit tjerë.

(Vijon)



## KDI-ja: Lipjani, Drenasi, Ferizaj dhe Prizreni, komunat më transparente gjatë 2023-s

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 30 maj - Komuna e Lipjanit është renditur e para në nivel vendi në raportin e publikuar të enjten nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), për vlerësimin e bërë sipas Transparometrit Komunal, për nivelin e transparencës së 38 komunave të Republikës së Kosovës për vitin 2023.

Komuna e Lipjanit vendin e parë e ndan me Drenasin, Ferizajn dhe Prizrenin, me një poentim të barabartë me 94 pikë (97.92 %).

Kryetari Imri Ahmeti ka pranuar mirënjohje nga KDI-ja për arritjen si komuna më transparente dhe është shprehur i kënaqur që Komuna e Lipjanit është konfirmuar si më transparente në nivel vendi. "Falënderoj të gjithë bashkëpunëtorët dhe qytetarët lipjanas, që zotimin tonë për transparencë e llogaridhënie, një parakusht i qeverisjes së mirë, po e realizojmë edhe në praktikë. Jam i kënaqur që komuna e Lipjanit në vazhdimësi ka shënuar progres në rritjen e transparencës falë angazhimit të zyrtarëve komunalë, andaj jam mirënjohës për kontributin e secilit që sot komunën e Lipjanit e bën komunë kampione në transparencë", ka thënë kryetari Ahmeti.



Transparometri Komunal vlerëson 48 indikatorë specifikë që matin elemente të rëndësishme të qeverisjes së mirë dhe përbushjen e obligimeve ligjore që lidhen me transparencën dhe

llogaridhënien në raport me qytetarët e tyre.

Në këtë publikim janë pasqyruar të gjeturat e nivelit të transparencës së institucioneve lokale për 38 komunat e Kosovës për vitin 2023.

Kuvendet komunale kanë arritur t'i përbushin indikatorët në masën prej 68.45 %, ndërsa zyrat e kryetarëve në masën prej 64.56 % e që ende ka punë për të arritur nivelin e synuar në 100 %.

Një nga sfidat kryesore që po ballafaqohen komunat dhe që vazhdon të jetë problem shumëvjeçar është mosfunksionimi i uebfaqeve.

Drejtori ekzekutiv i KDI/TIK, Ismet Kryeziu, ka vlerësuar se transparenca është themeli i një demokracie të qëndrueshme dhe të fuqishme në nivel lokal. Sipas tij, pa një qeverisje të hapur në nivel lokal qytetarët mbeten të painformuar dhe të pafuqishëm për të marrë pjesë aktivisht në proceset vendimmarrëse që ndikojnë në jetën e tyre të përditshme.

Nga ana tjetër, Selviye Kurti, menaxhere e projekteve në KDI/TIK, ka paraqitur raportin në detaje, duke theksuar se, sipas gjetjeve të Transparometrit Komunal për vitin 2023, transparenca komunale në përgjithësi ka shënuar një rënie të lehtë krahasuar me raportin e gjashtëmujorit të dytë të vitit 2022. Prandaj, ajo ka vënë në pah se është e nevojshme të vazhdohet puna për rritjen e nivelit të transparencës dhe llogaridhënies, për ta ruajtur dhe përmirësuar qëndrueshmërinë e nivelit të transparencës, sidomos në ato komuna që kanë pasur performancë më të dobët sa i përket përbushjes së standardeve të transparencës.


## Shtatë të arrestuar në rastin "Albkings", mbyllet përfundimisht grupi

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 30 MAJ - Autoritetet në Kosovë thanë se kanë arrestuar shtatë persona, të dyshuar se kanë kryer veprën penale të vjedhjes së identitetit dhe kredencialeve. Ata, sipas Prokurorisë Themelore në Prishtinë, dyshohet se administronin grupin, tashmë të mbyllur, "AlbKings", në Telegram. Në këtë grup shpërndareshin fotografi intime të personave të ndryshëm, numra kontaktues të tyre, foto-montazha dhe video intime.

Gjatë një konference për medie, kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Prishtinës,



Zejnullah Gashi, tha se, përveç shtatë personave të arrestuar, hetimet po vazhdojnë dhe ka "gjasa reale të zgjerohen" lidhur

me arrestimin e personave të tjerë që mund të jenë përfshirë në këtë rast. "Prokuroria Themelore e Prishtinës, në bashkëpunim me

Policinë e Kosovës, ka arritur me sukses të gjurmtojë, zbulojë dhe t'i arrestojë të gjithë kryesit e veprës penale së vjedhjes së identitetit dhe kredencialeve. Andaj, falë bashkëpunimit të ngushtë me qytetarët e Kosovës, kemi arritur që këtë rast delikat, sa i përket identifikimit të kryesve të kësaj veprë penale, t'i arrestojmë brenda afatit të shkurtër kohor. Target të rastit kanë qenë qytetarët e Kosovës, duke ua cenuar rëndë integritetin personal dhe moral të tyre, sa i përket shpërndarjes së fotove, videoincizimeve intime, që janë krijuar pasiguri te qytetarët", tha ai.

Ndërkaq, prokurorja e këtij rasti,

Erëza Bajrami-Kastrati, tha se ky rast është hapur në fillim të vitit 2024, pas publikimit në media për veprimtarinë e këtij grupi, që kishte numër të madh ndjekësish. Ajo tha se më 16 prill është arrestuar një prej administratorëve të "AlbKings", i dyshuar dyshimet për veprën penale "vjedhja e identitetit dhe kredencialeve". Më 23 prill është arrestuar një grua e cila, po ashtu, dyshohet se ishte një prej administratorëve të grupit. Ajo, sikurse personat e tjerë, gjenden në paraburgim. Prokurorja Bajrami-Kastrati tha se më 23 prill, po ashtu, se është arrestuar edhe administratori kryesor dhe themeluesi i grupit.

## Organizohen module trajnimi për stafin e UP-së

PRISHTINË, 30 MAJ - Qendra për Përsosmëri në Mësimdhënie në Universitetin e Prishtinës ka organizuar me sukses një sërë modulesh trajnuese për stafin e Universitetit të Prishtinës.

Pjesëmarrësit kanë shprehur mirënjohje të thellë për cilësinë e trajnimeve, atmosferën miqësore dhe gjithëpërfshirjen në diskutime dhe aktivitete.


Këtë vit qendra ka ofruar mundësinë e përzgjedhjes së

moduleve sipas nevojave individuale të pjesëmarrësve, gjë që është cilësuar si hap pozitiv dhe inovativ në përbushjen e nevojave për zhvillim profesional të stafit.

Kjo përvojë pozitive më së miri ilustruhet nga komenti i njërit prej pjesëmarrësve, i cili komentoi: "Ndarjen e trajnimeve sipas moduleve të ndryshme e cilësoj si gjë shumë pozitive si dhe shumë praktike. Ideja që

trajnimet do të zhvillohen në baza mujore është e përsosur. Ju përgëzoj".

Qendra për Përsosmëri në Mësimdhënie është e përkushtuar ta mbështesë stafin akademik për zhvillim profesional dhe ta përmirësojë vazhdimisht përvojën arsimore për studentët e universitetit. QPM-ja do ta vazhdojë ofrimin e moduleve trajnuese edhe gjatë kësaj jave dhe gjatë muajit qershor.





## Investimet në eficiencë energjetike, BERZh-i dhe donatorët ndihmojnë mbi 18 000 ekonomi familjare në Ballkanin Perëndimor

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 30 MAJ - Në më pak se shtatë vjet më shumë se 18 000 ekonomi familjare në Ballkanin Perëndimor (BP) investuan mbi 100 milionë euro në teknologjitë e kursimit të energjisë, të tilla si izolimi, pompat e nxehtësisë, dritare të reja dhe kolektorë diellore falë programit rajonal të Instrumentit për Financim të Ekonomisë së Gjellbër (GEFF) në Ballkanin Perëndimor, i lansuar në rajon në vitin 2017.

Për ta shënuar suksesin e programit, një konferencë rajonale "Greening the Western Balkans" u mbajt sot në Sarajevë, Bosnjë-Hercegovinë, e cila u ndoq nga pothuajse 200 palë të interesuara nga të gjashtë vendet, si Institucionet Financiare Partnere (IFP), rregullatorët dhe komunitetet e donatorëve. Përfaqësuesit e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) theksuan se këto përmirësime kanë çuar në një reduktim të emetimeve të CO2 me më shumë se 25 000 tonë në vit dhe 70 000 MWh kursim vjetor të energjisë. Gjatë konferencës pati diskutime të hollësishme në panele dhe sesione për shkëmbim të historive të suksesit, me qëllim të përshpejtimin të tranzicionit të gjellbër në vitet në vijim.

Pas zbatimit të suksesshëm të programit në nivel rajonal, si dhe rritjes gjithnjë e më të madhe të interesimit për financimin e eficiencës energjetike, kapaciteti financues i GEFF-it për Ballkanin Perëndimor u rrit nga 135 milionë euro në 415 milionë euro, me plane për zgjerim të mëtejshëm të programit.

Fondet do të kanalizohen përmes institucioneve partnere financiare lokale dhe do të mundësohen për një numër edhe më të madh të ekonomive



familjare në rajon që ta përmirësojnë eficiencën energjetike në shtëpitë e tyre. Aleksandra Vukosavljeviq, drejtoreshë e BERZh-it për institucione financiare për rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe për Evropën Lindore, ka theksuar se GEFF i BERZh-it për Ballkanin Perëndimor ka ndihmuar në përparimin e tranzicionit të rajonit drejt një ekonomie të gjellbër në sektorin rezidencial, duke sjell reduktimin e dukshëm të emetimit të karbonit, por edhe uljen e shpenzimeve të energjisë elektrike, duke përfituar kështu ekonomitë familjare dhe komunitetet, dhe duke rritur qëndrueshmërinë ekonomike dhe mjedisore. "Jemi të kënaqur që mbështetja jonë ia ka mundësuar një numri të madh të

ekonomive familjare në Ballkanin Perëndimor të investojnë në përparimin e eficiencës energjetike. Lufta kundër ndotjes së ajrit dhe ulja e intensitetit të energjisë janë ndër prioritetet kryesore të BERZh-it në rajon. Duke qenë se sektori rezidencial është ndër konsumuesit më të mëdhenj të energjisë në rajon, ne do të vazhdojmë ofrimin e mbështetjes sonë, me GEFF si një nga shtyllat tona kryesore mbështetëse për përmirësimin e eficiencës energjetike në sektorin rezidencial", ka pohuar Vukosavljeviq. Ngjarja në Sarajevë u organizua për t'i festuar arritjet e GEFF-it, por edhe për t'i shpërblyer institucionet financiare partnere. Çmimi i Ekselencës iu nda të gjitha 30 institucioneve financiare partnere nga Ballkani

Perëndimor. Gjatë konferencës pati diskutime dinamike në panel, të fokusuar në rolin kyç të sektorit financiar në nxitjen e transformimit të gjellbër të sektorit rezidencial, krahas diskutimeve për përshpejtimin e investimeve përmes reformës së politikave në kuadër të Valës së Rinovimit. Diskutimet u zgjeruan edhe në teknologji rezidenciale të gjelbra, investime në ndërtesa të qëndrueshme dhe strategji për përmirësimin e përdorimit të ardhshëm të GEFF-it, të gjitha të mbështetura me histori të suksesit të GEFF-it. GEFF për Ballkanin Perëndimor u krijua nga BERZh-i me mbështetjen e donatorëve dhe siguron linja krediti të specializuara për investime të gjelbra me ndjeshmëri gjinore për

sektorin rezidencial (banorë individualë, banesa kolektive dhe ndërmarrje për menaxhimin e banesave, ofrues të shërbimeve, prodhues dhe shitës të teknologjive dhe materialeve të gjelbra dhe kompani ndërtuese). GEFF mbështetet edhe nga stimujt në formën e investimeve dhe bashkëpunimit teknik, nga fondet e granteve të Bashkimit Evropian (BE) përmes Kornizës së Investimeve për Ballkanin Perëndimor, qeverisë së Austrisë, Japonisë, Austrisë dhe Zvicrës përmes Partneritetit me Ndikim të Lartë në Veprimin Klimatik (HIPCA). HIPCA mbështetet nga Austria, Kanadaja, Finlanda, Korea, Holanda, Zvicra, Spanja, Fondi Ndërkombëtar për Bashkëpunim dhe Zhvillim (ICDF) i Tajvanit dhe Mbretëria e Bashkuar.

## Ministria e Financave, pensionistëve: Kujdes nga lajmet e rreme për skemat pensionale



PRISHTINË, 30 MAJ - Ministria e Financave përmes një njoftimi për medie ka paralajmëruar pensionistët të kenë kujdes lidhur me lajmet e rreme për skemat pensionale në Kosovë. MF-ja thekson se lidhur me çdo ndryshim eventual, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve kërkon nga të gjithë përfituesit e skemave pensionale t'i ndjekin vetëm njoftimet zyrtare të MFPT-së dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe t'i shmangin informatat dhe shërbimet e tjera jozyrtare. "Të nderuar përfitues të skemave pensionale në Republikën e Kosovës, siç ju kemi informuar edhe përmes një

njoftimi paraprak, udhëzoheni të jeni të kujdesshëm ndaj informatave të rreme që qarkullojnë këto ditë, të cilat kanë për qëllim keqinformimin e përfituesve të skemave pensionale në Kosovë dhe mund të përbëjnë skema mashtruese apo edhe tendencë për keqpërdorimin e të dhënave personale. Ftojme qytetarët të kenë kujdes e të mos bienin pre e mashtrimeve dhe dezinformatave. Rastet e tilla, kur u premtohen shuma parash në këmbim të një pagese tani, t'i paraqesin edhe në organet e rendit", thuhet në njoftimin për medie.



# Sami Frashëri dhe persishtja



**Nga: Lumo KOLLESHI**

Të shkruash për emërdriturin Sami Frashëri, nuk është aspak e lehtë, pasi përmasat e tij e kapërcejnë ngrehinën një biblioteke të tërë (po të kemi këtu parasysh dhe bibliotekën e tij personale); atë nuk e mban dot dhe përcaktimi “akademik”, pasi ishte dhe mbetet një akademi më vete. Është shembulli më i rrallë në botë që, në mënyrë autodidakte, plotësoi fushën e njohjes dhe krijoi një univers të vetin.

Tek ai nuk di se kë takon të parin. Sa përballësh me shkencëtarin e enciklopedisë gjashtë vëllimëshe *Kamus yl alam*, në krahun tjetër të befason leksikografi i shquar. Por, ai nuk ndalet thjesht dhe vetëm në këto fusha.

Shfaqet si romancier e me romanin *Dashuria e Talatit me Fitnetin* dhe, qoftë vetëm me këtë, do të shënojë të parin roman modern në letërsinë turke.

Po dramaturgjia e tij, po përkthimet nga frëngjishtja e persishtja në gjuhën turke? Po filozofi, humanizëm? Po një nga ideologët më të mëdhenj të Rilindjes sonë kombëtare? Po vepra e tij që ka lënë trashëgim për brezat e cila sipas studiuesve të Samiut vërtitet nga 20 mijë deri në 30 mijë faqe? Po dorëshkrimet e pabotuara e të pagjendura?

Janë një seri pyetjesh që kërkojnë të marrin përgjigje për t'i dhënë hapësirën dhe dimensionin e plotë kësaj figure emblematiske të kombit tonë, që shpesh e kanë lënë në harresë.

Në kumtin tim do të përpiqem të parashtroj e t'i përgjigjem vetëm një pyetje: Pse u përkushtua kaq shumë Samiu me qytetërimin dhe kulturën persiane në përgjithësi dhe me atë iraniane në veçanti? Është fakt i pamohueshëm që kontributi i tij kryesor ishte në turkologji, por qëllimi përfundimtar i gjithë veprës madhore të këtij dijetari të pasohq mbështetej në dy shtylla të fuqishme të një filozofie moderne: e kaluara e qytetërimeve dhe raporti me qytetërimin modern, në përgjithësi, dhe vlera që shton çdo popull shton në trashëgiminë botërore, në veçanti.

Duhet pohuar se shumica e veprave kushtuar qytetërimit pers kanë mbetur të pabotuara dhe kjo kërkon para së gjithash ndjeshmërinë e institucioneve për ta vjelë, sistemuar e sjellë në shqip. Po këtu do të shtoja se vepra dhe kontributi i Samiut rreth qytetërimit islam në përballje me atë perëndimor, si një vepër me interesa të mirëfillta shkencore, u kundërvihet qëndrimeve fanatike të mjaft studjuesve perëndimorë dhe, në rastin më të mirë, ajo mund të konsiderohet dhe vetë dhimbja më e madhe e shkencëtarit. Lulëzimi i qytetërimit persian dhe rilindja persiane, në shumë fusha të njohjes, i sollën kulme dhe qytetërimit botëror.

Samiu vëren se pas pushtimit arab të Iranit, persishtja e re u bë krahas arabishtes gjuhë e islamit, ndërsa qytetërimi iranian luajti në zhvillimin e kulturës islame po atë rol që luajti qytetërimi grek në

konstituimin e kristianizmit dhe kulturës së tij. Që nga kjo kohë Persia do t'i sillte botës emrat e mëdhenj, si: Rumi, Hafizi, Sadiu, Omar Khajami dhe shumë poetë e shkencëtarë. Këtë qëndrim objektiv të Samiut do ta mbështesin më vonë dhe Hafiz Ali Korça (*nën flamurin alevijan natë e ditë mentoheshin se qysh do ta ringjallnin vetëqeverimin e Persisë*) apo Fan Noli me rastin e përkthimit të rubairave të Omar Khajamit. Analiza dhe përfundimet e tij shkencore nuk mbeten mbrapa nga mendimi shkencor bashkëkohor, përkundrazi ai vjen krejt i zhveshur nga ai i paragjykimëve eurocentriste të autorëve të kontinentit. Ja si shprehet Noli: *Që në shekullin e gjashtëmbëdhjetë pas Kerishtit, Persia ka pasur një Përlindje kulture, diturie dhe letëryre, që prodhonte një tufë mejtimitarësh dhe poetësh të mëdhenj si Firdusi, Avicenna (Ibn-i Sina), Omar Khajami, Atari, Nizami, Saadi, Rumi, Hafiz Shirazi, Xhami dhe Hatifi. Nga kjo përlindje e shkëlqyer, që buron drejtpërdrejt nga qytetaria greko-romake, lindi përlindja arabe, e cila me anën e Spanjës influencoi Evropën medievale dhe gatit përlindjen italiane, nënën e qytetarisë moderne.*

Nga ky lloj ndikimi dhe influencimi të cilin e ka paraparë Samiu, le të sjellim në kujtesën e auditorit, inspirimin e krijuesve me famë botërore si Hajne, Gëte apo dhe Fitzxherald. Gëtja jo vetëm që u frymëzua nga kjo letërsi në veprën e vet *Divani*

*perëndimorolindor*, por ai theksoi: *Flitet se persët nga të gjithë poetët e tyre për pesë shekuj, njohim të denjë vetëm shtatë sish, por dhe midis të tjerëve, të lënë anash prej tyre, shumë do të ishin më të nderuar, më të mëdhenj se unë.* Për të kundëruar për së thelli lavdinë e Persisë nuk është se Rubaitë u shkruan në gjuhën e saj të bukur, por ca më tepër që këto kryevepra të një “dinësëzi”, siç e përcakton Noli, Khajamin, kanë mundur të shpëtojnë nga shoqata e fanatizmit orientale dhe të arrijnë në e përtej kohës sonë. Liria e mendimit është boshti kryesor i kësaj kryevepre, si një fe përmbi fetë.

Ja pra një fillesë që i vjen në ndihmë vëllazërimit të qytetërimeve, nga e cila është nisur Samiu për të sjellë nga qytetërimi pers në popujt e perandorisë, por edhe më tej se lindja e perëndimi.

Si një nga orientalistët më shquar të kohës së vet, Samiu do të zbulojë e do të na sjellë lidhjet e ndërsjellta mes kulturës perse në përgjithësi e asaj iraniane në veçanti me botën dhe kulturën shqiptare, gjurmë të cilat kanë depërtuar natyrshëm përmes vjershërimit në letërsinë shqipe. Si gjuhëtar ai ka dhënë pikëpamjet e veta për lashtësinë e gjuhës perse, madje ka zbuluar dhe disa lidhësi gjuhësore midis persishtes e shqipes.

Bota perso-iraniane, sa e lashtë dhe po kaq mistike, eksplorohet prej tij jo si një soditës i thjeshtë apo me përshkrime empirike. Samiu depërton në thellësinë e

gjërave dhe me zellin e shkencëtarit që vlen për t'u admiruar edhe kur jep përfytyrimin gjeografik të Iranit të kohës së tij, edhe kur na jep në mënyrë të hollësishme historinë e lashtë iraniane, po dhe kaq i përkorë mbetet kur pasqyron në mënyrë shkencore qytetërimin e lashtë persian.

Nuk mund të mbetej jashtë vëmendjes së Samiut letërsia persiane dhe sidomos poezia e Firdusiut, për të cilin do të flasim në një syth të veçantë, por kjo poezi në gjuhën perse, e cila, po sipas Samiut, *persishtja është një gjuhë e krijuar për poezinë dhe poezia është shpikur për atë gjuhë.*

Si për studimin e kësaj poezie, ashtu dhe në përkthimet e bëra prej tij në turqisht nga letërsia perse, do të udhëhiqej nga kriteret shkencore dhe estetike. Kështu do të ndodhte kur përgatiste për botim në turqisht librin *Hurdeçin të Mulaim Naxhiut* dhe rigorozitetin e shkencor e estetik të tij i vë në dukje në parathënien e këtij botimi.

Po këtu vlen të theksohet edhe një fakt i nënvizuar nga vet Samiu: *Kohë pas kohe, i lodhur nga detyra të rënda të marra përsipër-detyra të ftohta, si hekuri të rënda... për ta qetësuar mendjen nga lodhje e madhe... i kthehej poezisë perse.* Është fakt që ai nuk ishte poet dhe nuk krijoi poezi, por leximin dhe përkthimin e saj ai nuk e ndali. Edhe kur ishte i mbytur me punime të fushave të tjera, poezia do të mbetej si prehje e bukur. Bukuria dhe eleganca e poezisë persiane do të mbetej për Samiun





kura më e mirë për çlodhje në mënyrë estetike. Përsëri dhe me çlodhjen e vet ai sërish do të përkthente. Samiu dinte çfarë lexonte, madje ai ishte sqimatar në lexime, sepse donte vlera të vërteta poetike. Nuk mungonte dhe nuk përtonte që përkundër këtyre vlerave, ai do të mbante qëndrim prej kritiku të mirëfilltë. Le t'ua lë po këtu radhën fjalëve të tij si vlerësues: *Khajami është nga poetët më të njohur e nga më të mëdhenjtë shkencëtarë, filozofë sufijnj të botës muslimane ... Khajami kishte zotësi të madhe dhe një bagazh të madh në dituritë mendore, në dituritë natyrore, në filozofi dhe tesavvuf (misaticizëm). Rubairat që ka lëvruar përfshijnë shumë sende të holla dhe të thella që kuptimi i tyre njeriun e çon shumë larg. Fjalët e tij janë shenjë inteligjence spirituale, që me pak fjalë tregojnë shumë hollësi.*

Edhe pse Samiu nuk shkëlqeu në fushën e poezisë si vëllai i vet Naimi, ndërsa nuk dihet se ka shkruar ndonjë varg në shqip apo turqisht, megjithatë ai ndriçimin e vet e lë si studiues i saj. Duke qenë se jemi brenda tematikës dhe frymëzimit nga poezia persiane, ku çdo krijues apo studiues ka edhe idhujt e vet, Samiu do të përqendrohej në tro drejtme vetëm të një nga poetët më të mëdhenj të Persisë, të Firdusiu. Ai parapëlqen së pari të ballafaqohet me të në rrafshin studimor; së dyti, ta sjellë me përkthimin në gjuhën turke Firdusiu dhe kryeveprën e tij *Shahname-ja (Libri i mbretërve)*; dhe, së treti, të ndikohet prej tij dhe t'u drejtohet motiveve të

*Shahnamesë* dhe të na sjellë vepra origjinale për kohën e vet, madje me vlerë edhe për të sotmen. Samiu dhe Firdusiu janë një përballje me njëri-tjetrin, ku në njërin anë qëndron një poet shumë i madh i përmasave botërore dhe, në anën tjetër, një njeri shumë i madh i botës shqiptare i përmasave jo vetëm kombëtare – si Shemsedin Sami Frashëri, orientalisti dhe enciklopedisti i shkëlqyer që kapërcen dhe kohën e vet jo vetëm në juglindjen e Evropës, por edhe më tej Lindjen e Afërme apo të Mesme.

Samiu, si studiues i kësaj vepre madhore e të papërsëritshme, vlerësimet e veta për këtë vepër do t'i bënte në parathënien e përmbledhjes së *Shahnamesë* në persisht dhe në përkthim e saj në turqisht, mbetur në dorëshkrim. Për të kuptuar më mirë dimensionin dhe vendin që zë Firdusiu, nuk po zgjatemi dhe ia lëmë fjalën vet Samiut: *"Shahnameja" është një vepër që meriton të përmendet si kryevepër e letërsisë persiane dhe, ndoshta, kryevepër e letërsisë islame. "Shahnameja" është bërë njëherë, nuk është e mundur të bëhet edhe një tjetër si ajo. Kjo vepër, është ndër ato vepra të rralla që kanë hyrë në histori si monumente. Ajo së bashku me "Ramajanën" e Hindit të vjetër dhe "Iliadën" e Greqisë së lashtë, janë vepra madhështore të cilat do të ekzistojnë sa të jetë bota.* Po këtu, Samiu jep vendin që zë e do të zërë Firdusiu jo vetëm poeti më i madh i botës iraniane, por dhe një nga poetët më të mëdhenj

të botës. Edhe pse mbetet një vepër me rimë e ritëm, kjo sërish është po kaq spontane dhe e frymëzuar, ku bukuria dhe eleganca vijnë me një qartësi të mahnitshme.

Nisur nga fakti që *Shahnameja* mbetet një vepër vëllimore dhe, për lehtësi leximore nga ana e nxënësve, Samiu do t'i hynte një tjetër pune të mundimshme për të dhënë nën titullin *Ajka e Shahnamesë*, një përmbledhje të saj në gjuhën perse, duke treguar edhe në këtë rast mendimin e vet racional. Por, ajo që të bie në sy në një punim të tillë është zhveshja prej Samiut nga fjalët arabe.

Gjithsesi një ndërmarrje e tillë nuk ishte e lehtë, por jo e pamundur për një shkencëtar të përmasave të Samiut që shquante për vullnetin e tij të hekurt në zënien dhe përfundimin e punëve. Kështu, si *Ajkën e Shahnamesë* në persisht dhe përkthimin e saj në turqisht, duke i qëndruar besnikërisht origjinalit, dhe kjo mbetet si një veçori e rrallë e punës së tij, ai arrin t'i kryejë me sukses të dyja. Edhe në këtë rast do të vërejmë se Samiu, ndryshe nga përkthyesi turk Qemal Pashai i cili e kishte përkthyer këtë vepër para tij në turqisht, por që kishte përzgjedhur prej saj vetëm ato pjesë që lidheshin me moralin apo këshilla dhe tek-tuk ide filozofike, titaniku shqiptar do të përqendrohej në thelbin e veprës firdusiane. Ai përqendrohet te përkthimi i situatave, i ngjarjeve dhe i ndodhive të kreshnikëve. Firdusiu i sjellë prej tij është më i plotë dhe më i madh – pasi pikëpamjet historike e filozofike

dhe etike, të paraqitura këto bukur dhe poetikisht – edhe pse do të përballlej me censurën pendorake. Siç nënvizuar dhe pak më lart, prej veprave të letërsisë persiane dhe më konkretisht prej Firdusiu, Samiu jo vetëm që u mrekullua nga bukuria dhe ëmbëlsia e tyre, nga forca përshkruese e medituese në raport me mesazhet filozofike që buronin prej tyre, por gjithashtu ai u ndikua drejtpërsëdrejti si krijues. Një tërheqje e tillë nuk ishte aspak rastësore, por kjo vinte nga fuqia magnetike e këtyre autorëve dhe sidomos prej Firdusiu. Nuk është rast i vetëm dhe vetëm te Samiu. Prej *Shahnamesë* gjashtëdhjetëmijëvargëshe, ku përmbledhjen historitë më në zë të Iranit, do të ndikoheshin jo vetëm poetë Lindjes, por edhe të Perëndimit si, Henrik Hajne, Lamartin, Viktor Hygo dhe Johan Volfang Gëte. Kështu Samiu u ndikua nga motivet e *Shahnamesë* në drmen *Gjave*, botim i vitit 1876, dhe *Sohrab* në vitin 1896, fati i së cilës nuk dihet. Xhamshidi i Firdusiu, që i ftonte njerëzit në rrugën e Zotit, do të arrestonte mbretin despot të Arabisë. Shejtani do të puthte supet e këtij mbreti vrasës dhe aty mbinë dy gjarpërinj që, për t'i ushqyer, sulltani do të vriste çdo ditë dy njerëz. Ky motiv i marrë prej Samiut vjen me ndryshime nga modeli ku është mbështetur, dhe drama ka fituar tipare krejt origjinale. Në paralajmërimin që ka bërë më parë vetë autori se përmbajtja e dramës *Gjave* do të kapërcente vet kohët – duke pararendur te ato pagane,

tematikë kjo e panjohur për shqiptarët e vet turqit, për t'i hapur rrugë të lirë qëllimit patriotik dhe humanist si për popullin e vet ashtu dhe për popujt e tjerë të perandorisë, për çrrënjosjen e despotizmit dhe emancipimin e tyre. Figura e farkëtarit në këtë dramë vjen si simbol i luftëtarit popullor që lufton për liri. Madje Samiu shkon deri atje sa t'i vërë nëntitull *Tirania e tiranit* dhe kjo do t'i hapte shumë peripeci për t'u publikuar. Një fakt të tillë e nënvizon vet Samiu kur i shkruan të vëllait, Abdylit në Janinë. Drama i kishte pëlqyer dhe vet ministrit të Arsimit të perandorisë për kohën, me kushtin e heqjes së nëntitullit. Një tjetër shtysë, po nga Firdusiu, është dhe figura Sohrabit e cila vjen nga eposi iranian dhe historia e Rustemit me Sohrabin që kanë të përbashkët besën, por edhe këtu ngjarjet do të vihen në terrenin shqiptar. Megjithatë kjo dramë ka mbetur në dorëshkrim.

Nga gjithë kjo parantezë për ndikimet e krijuesit Sami prej Firdusiu dhe letërsisë persiane, mund të arrijmë në konkluzion të vetëm: mjedisi dhe koha kur krijoi e punoi Samiu, tregojnë se kemi të bëjmë me një personalitet të paarritshëm, ku shkencëtari u paraprin të gjitha arritjeve të tij, ku përkthyesi dhe krijuesi janë në harmoni të plotë me objektivat e lëvizjes kombëtare shqiptare dhe të zgjimit të lëvizjes demokratike edhe te popujt e Perandorisë Osmane. Samiu mbetet iluministi më i madh shqiptar, pavarësisht se pjesa më kontributive e tij i përket turkologjisë.



# Sami Frashëri dhe persishtja

Nga: Rudina LLAZARI

“Nji komb qi lindet ka nevojë për fatosat qi desin. Por, fatosat qi desin, nuk kane ç’të bajnë në nji komb, qi i harron dhe i përbuzë”. Kështu do të shprehë drejtuesi i revistës Hylli i Dritës, At Gjon Shllaku (1907–1946), në numrin 3-4 të kësaj reviste. “Tjetërkund, njerëzit e idealit, në u mbythshin për së gjalli, nderohen për së dekuni. Ndër ne ata mbyten dy here; edhe harrohen”. Apostrofime në dukje të thjeshta, parandjenja dhe profeci që tingëllojnë deri vonë si tepër të trishtta. Në mëngjesin e zymtë, të vrenjtur dhe me shi Shkodre, të 4 marsit 1946, zemrat e shkodoranëve dridhen nga breshëritë e automatikëve dhe jehonat që vinin nga Zalli i Kirit, vendi i namun ku pushkatoreshin “mëkataret” e kohës së kuqe.

Nën plumbat e skuadrës ekzekutive ranë njëri pas tjetrit, përdhe, trupat e shtatë të dënuarve me vdekje ndër të cilët katër ishin klerikë katolikë. At Gjon Shllaku qe njëri ndër ta. Nuk ishte hera e parë që në të zbardhur të dritës në qytet të dëgjoheshin të shtime të tilla me ushtime të “xanun” si ato që bien në mish njeriu.

Në zakonin e fituar rishtazi, pushkatimet e “heretikëve” bëheshin në orët e para kur njerëzit ishin ende në shtroja. Pas pushkatimit, zakonisht trupat e të vdekurve liqeshin ashtu njëri mbi tjetrin, si të ishin thasë plehu – në dispozicion të qytetarëve, për tërë ditën.

Në muzg të natës, ashtu grumbull siç ishin, hidheshin në një gropë të përbashkët që mbulohej mirë, mundësisht të mos mund të dallohej më. Ky qe fati që parandjeu në harresën e tij edhe At Gjon Shllaku. “Ne, nesër, së bashku edhe me nji koleg temin, shkumë kinse për me shëtite, kah vendi i pushkatimit, me qëllim që të vërtetojmë se ku i kishin vorrue. Kurkund shenjë grope dhe as dheu, të çuem rishtas. Ma vonë mormë vesh se gropën e kishin çele natën, afër shtratit të lumit, në zall që e mbulon lumi mbas shinave. Dheun tepicë e kishin tretë dhe gropën e kishin rrafshue me kujdes, me fundri të qytetit: teneqe, kutia zhele, në mënyre që të mos dukej shenjë dhe as gjurmë për krimin e kryer”, shprehet në kujtimet e tij për At Gjon Shllakun, Pal Duka-Gjini. (Pseudonimi letrar i At Daniel Gjeçaj).

Në Shkodër, At Gjon Shllaku njihet si një ndër më intelektualët klerik katolik. Filozof, gazetar, profesor, At Shllaku njihet edhe politikan. Në historinë e mendimit demokristian, thuhet të jetë i pari kryetar i Partisë Demokristiane Shqiptare. Madje, duket se kjo ka qenë edhe një ndër shkaqet kryesore që e çuan atë drejt fundit dhe rrokamës të pashmangshme. Regjimi nuk mund të pranonte në



rjedhën e kohës ata që ishin në oponente ideologjike me të. Le që për njerëz të tillë, si At Gjon Shllaku, ishte i mjaftueshëm fakti se qe prift dhe që bënte pjesë në një elitë të zgjedhur intelektualësh. Të vjetrit e kujtojnë shumë mirë, megjithëse ai nuk është më që nga fillim marsi i vitit 1946. Duke kujtuar takimin e parë të tij, me at Gjon Shllakun, At Zef Pllumi tregon; “Ishte një burrë i ri, rreth të tridhjetave, por i plakun para kohe. I shkurtër, i thatë, i zbehtë, me nji palë syze të zeza që i mbulonin gjysën e fytyrës që qeshte. Jo i bëshëm në trup. Më shumë i mesëm se i gjatë. Me një paraqitje të përvuajtur. Fytyrë e një frati të zakonshëm, që pamjes të jashtme nuk i jep as rëndësi dhe as peshë. I këndshëm në të folur dhe plot njerëzi. Fytyrën dhe formën e kokës karakteristike të racës ilire. Ballin të shpërvjelur dhe flokët të rrallë”.

Kështu e mbajnë mend në kujtimet e veta, ata që e njohën at Gjon Shllakun. “Dinte me u mbajt në shoqni dhe në çdo ambient a rend shoqruer, ruante të pacenueshëm dinjitetin e meshtarit, zotnisë e filozofit praktikien dhe sociologut, pasurinë e nji kulture të hapët dhe të thellë. Kishte një mbamendë të fortë dhe reflektive. Lexonte shumë dhe çka lexonte, e thandronte në mendje me kollajsi të çuditshme”, thotë për të, Pal Duka-Gjini.

Njohës i shkëlqyer i filozofëve më të përmendur të kohës italiane franceze dhe gjermane, nga ku duket se ka dalë edhe një farë interesi i tij, që mbase për momentet kur u shfaq, mund të quhej i imponuar për politikën. I gatshëm për të diskutuar mbi çdo çështje të diturisë njerëzore dhe letrare. Dinte të sillej me të gjithë, pavarësisht se kishte parapëlqim intelektualët dhe të zgjuarit e kohës.

Megjithatë, fliste përzemërsisht njësoj me të gjithë. Në Shkodër kujtohet miqësia e tij me doktor Shirokën i cili, në bisedë me të, edhe kur vinte rasti përdorte terminologjinë e ngushtë të zhargoneve të shkencës humane

të njeriut.

Po kështu mbahet mirë në mend edhe një episod tjetër. Gjatë një vizite të një grupi albanologësh italianë në Shkodër, At Gjon Shllaku është i zoti i shtëpisë. Në listën që kërkohet të bëhet për një dhuratë me libra, ai vërteton të qenit njeri erudit dhe me kulturë e shije letraro-ditunore. At Gjon në Liceun Françeskan ku jepte mësim, konsiderohej si profesori më i përgatitur. Në kohën e vet thuhej se ishte njeriu më i lartë i kulturës shqiptare. “E kam pasë profesor në Liceun ‘Illyricum’ dhe na jepte mësim në fiziko-kimi, në frëngjisht dhe në ekonominë politike. Ishte profesori më simpatik. Në klasë na fliste për marrjen e Bastijes, që ndryshoi botën. E kuptonim na? Sigurisht që jo ...”, thotë At Zef Pllumi, në kujtimet e veta.

Në drejtimin e Hyllit të Dritës, aftësia e Padre Gjonit spikati shkëlqyeshëm. Shpejt revista u shndërrua në një forum kombëtar, me pjesëmarrje të personaliteteve më të shquara të kulturës, si; Eqrem Çabej, L. Mirdita, Kol Naraci, Frano Alkaj, Prek Kaçinari etj. Ai mblodhi rreth vetes penat më të mprehta të kohës. Në vatrën që inicioi Fishta i madh, ku u shkri platforma e një Shqipërie të lirë dhe të përparuar, u ulën në kuvend si dikur, pleqtë e kanunit dhe shkrimtarët e rinj të krishterë ose jo, por gjithmonë, adhurues të një Zotit.

Ai pranoi ide moderne e përparimtare, por pa ia shmangë parimeve kristiane e kulturës shqiptare. Në vitin 1945, intelektualët shkodoranë organizuan konferencën për krijimin e Shtëpisë të Kulturës. “U ftua edhe Padër Gjonit, gjë që ai e përqafoi me entuziazëm. Në atë konferencë që e zgjodhi Padër Gjonin kryetar nderi, ai mbajti fjalimin përurues, fjalim që do të mbetet i paharruar për auditorin e asaj dite”, thotë kështu Zef Zorba. Të gjithë e njihnin Padre Gjonin dhe ishin të bindur se më nismëtar të tillë, kultura, ekonomia dhe arti do të lulëzonin në Shqipërinë e pavarur.

Në lajtmotivin e klerikëve është e

njohur edhe jeta e martirizuar për fe dhe për atdhe. Një jetë të tillë pati edhe martiri që njihet me emrin Gjon Shllaku. I lindur në Shkodër, djep të kulturës dhe qendër të kristianizmit, ai pati emrin Kolë në pagëzim. Ende i vogël, hyri në Kolegjin Françeskan. Në tetor 1922, shugurohet prift dhe filloi jetën rregulltare, duke ndërruar edhe emrin e pagëzimit në Gjon. Diplomohet në Holandë dhe Belgjikë, në Universitetin e Levainit, ndërsa në Francë, në Universitetin e Sorbonës, ndërsa kryen edhe një kurs për gazetari, çka do të jetë një ndër synimet e tij kryesore në drejtimin e Revistës Hylli i Dritës.

Simbas traditës së françeskanizmit në Shqipëri dhe si pasojë e edukatës të fituar nga të mëdhenjtë me zhgun – Bardhi, Gjeçovi, Harapi, Fishta dhe Rrota, që ishin mësues në shpirt dhe në zemër – Padre Gjonit ndikoi te të rinjtë jo veç ndjenjat fetare, por edhe kulturën e shëndoshë dhe ndjesitë kombëtare.

Edhe atij, si etërve të Provincës Françeskane, i dha jete binomi “Për fe dhe për atdhe”. Ajo që e dallon në misionin e tij meshtarak e françeskan, është penda dhe shkrimi. Këtu dha provat e para të një zotësie të rrallë dhe të një talenti të veçantë. Shkroi pak sepse koha qe e shkurtër e aktivitetit të tij dhe rrethanat e vështira me të cilat u gjet në momentet që hyri në radhët e shkrimtarëve.

Në vitin 1946, për klerikët e krishterë në Shqipëri shënohet akti i parë dramatik i asaj tragjedie e cila dalëngadalë do ta çonte kishën e këtij vendi në asgjësim të plotë të çdo shprehje të jashtme të besimit. “Çdo ditë e më tepër rëndoheshin retë e zymta, që lajmëronin stuhi e shtrëngatë ndër ne. Më kujtohet si sot trishtimi që na kishte mbulue të gjithëve dhe më ka mbet në mendje gjendja shpirtërore e Padër Gjonit – tash më takon mua, por mjerisht s’jam as i pari as i mbrami. Të lutemi që Zoti të na japë forcë dhe zemër, për të përballuar martirizimin”, thotë kështu Pal Duka-Gjini. Akuzat qenë gati. Ai ishte me ideale

demokristiane.

Sipas disa treguesve, në fund të vitit 1945 qe dukur në Shkodër, Sejfulla Malëshova. Thuhet dhe madje është e dokumentuar që ai të ketë biseduar me Padër Gjon Shllakun, për krijimin e një Partie Demokristiane. Këto ishin argumentet që u sollën në gjyqin farsë ndaj priftit të nderuar.

Një nga përkthyeset në shërbim të Enver Hoxhës, tregon se ka dëgjuar një bisedë të Hoxhës me ambasadorin jugosllav: “E mbytëm Padër Anton Harapin e me këtë kemi plagos për vdekje klerin katolik”. Sipas rrëfimit, diplomati serb i është përgjigje; “Po! Po! Por, keni ende gjallë Padër Gjon Shllakun, i cili peshon shumë. Duhet, sipas porosisë të qeverisë seme, të zhdukni Shllakun dhe të shkatërroni në kulm dhe themel çerdhen e klerit katolik në Shkodër”.

Atë e morën në shkurt të vitit 1946. E nxorën nga klasa, ndërsa u jepte mësim nxënësve. Madje, nuk kishte arritur të shkruante as temën në regjistër të klasës. Atë natë në Radio-Shkodra u dha lajmi se “Krimineli Gjon Shllaku qe kapë duke kaluar kufirin, për t’u arratisë”. Që nga ai moment, ai ndërroi sallën e mësuesit me dhomën e torturave.

“Kur ne të tjerët kryem mësimin në dhjetë minuta, në gojë të secilit kaloi fjala. E pat edhe Padër Gjonit”, tregon Pal Duka-Gjini në kujtimet e tij. Tani Padër Gjonit bashkohej me viktimat të tjera, në pritje që të nxirreshin në arenën e koloseut të Rozafës. Shtonte rreshtin e Padër Daniel Dajanit dhe të Padër Faustit, “anëtar të organizatës antipopullore, ‘Bashkimi Shqiptar’”. Mbi të binte edhe akuza e të qenit si kryetar i Partisë Demokristiane, në fillimet e saj. Në gjyq pati një avokat të guximshëm dhe tepër të përgatitur si nga ana intelektuale, ashtu dhe profesionale – Myzafer Pipën. Ky ishte ish-student i tij, e njihnte personalitetin e Padër Shllakut dhe nuk e pati të zorshme edhe mbrojtjen, megjithëse pati pasoja prej tij. Sipas kujtimeve të Pal Duka-Gjinit, Myzafer Pipa ka pranuar të mbrojë Padër Gjonin dhe në një koment tha: “Shka mund të bëjë juristi, ku s’ka ligje dhe as drejtësi? Si mund të mbrojë një njeri, në kje se në kohë, para se te provohet apo jo faji i tij, asht i dënuem”?!.

Një gjyq tragjikomik, Padër Gjonit dënohet me vdekje. Akuzat të planifikuara nga lart, paraqitën Padër Gjonin, si ideologun dhe krijuesin e Partisë Demokristiane dhe organizatorin dhe udhëheqësin e “Bashkimit Shqiptar”. Fajtor për vdekje, jo vetëm si kundërshtar regjimi, por edhe si “kriminel dhe njeri i dëmshëm për popullin dhe kombin”. Dënimi me vdekje kishte ardhur prej kohe nga Tirana zyrtare. Pas kësaj, ekzekutimi ishte një rutinë.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Kosova dhe Shqipëria mësojnë kundërshtarët e raundit kualifikues në futsal

**NYON, 30 MAJ** - Përfaqësuesja e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë në futsal kanë mësuar kundërshtarët në kualifikueset e Kampionatit Evropian. Shorti i hedhur të enjten në selinë e UEFA-s në Nyon të Zvicrës e ka pozicionuar Kosovën në Grupin

10 derisa Shqipërinë në atë 6. “Dardanët” do të kenë punë me Francën, Gjeorgjinë dhe Bullgarinë në Grupin 10. Ndërkohë kuqezinjtë ndodhen në Grupin 6 dhe do të përballen me Danimarkën, Armeninë dhe Kazakistanin. Të gjitha ndeshjet

kualifikuese do të luhen në periudhën 9 dhjetor 2024-16 prill 2025 me sistem vajtje-ardhje. 10 vendet e para të çdo grupi do të kalojnë menjëherë në finalen e Kampionatit Evropian të Futsalit, ndërsa tetë vendet e dyta më të mira do të shkojnë në

“play-off”, ku do të luajnë shanset për t’u kualifikuar në finalen e Evropianit të Futsalit. Ndeshjet e raundit “play-off” do të luhen më 15-24 shtator 2025, ndërsa finalen e Kampionatit Evropian të Futsalit do të organizohen nga Letonia dhe



Lituania në periudhën 18 janar-8 shkurt 2026.

## Foda: Duam fitore ndaj Norvegjisë

Shefi i shtabit teknik në Përfaqësuesen e Kosovës, Franco Foda, ka kërkuar fitore në miqësoren ndaj Norvegjisë, e cila zhvillohet para fillimit të Ligës së Kombeve më 5 qershor në Oslo. “Ndeshja kundër Norvegjisë është përgatitje e mirë për ndeshjet e Ligës së Kombeve që na presin. Kemi ekip të mirë e të balancuar. Jemi maksimalisht të përgatitur dhe duam të fitojmë”, ka deklaruar Foda



garat evropiane. “Kam qenë prezent shpesh në ndeshjet e Superligës. Në këtë ligë ka shumë lojtarë të talentuar dhe shumë prej tyre janë ftuar. E rëndësishme është të vazhdohet të investohet në infrastrukturën sportive sepse është investim për të ardhmen e futbollit”, ka deklaruar Foda.

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 30 MAJ** - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll më 5 qershor e zhvillon ndeshjen miqësore ndaj Norvegjisë në Oslo nga ora 19:00. Përzgjedhësi i Kosovës, Franco Foda, ka thënë se synim i “dardanëve” është fitorja në ndeshjen e fundit para Ligës së Kombeve. “Ndeshja kundër Norvegjisë është përgatitje e mirë për ndeshjet e Ligës së Kombeve që na presin. Kemi ekip të mirë e të

balancuar. Jemi maksimalisht të përgatitur dhe duam të fitojmë. Do të bazohemi në formën e lojtarëve, në profilin e tyre. Kjo do të jetë mundësia e fundit para lojërave të Ligës së Kombeve, që t’i testojmë dhe ta kemi një përshtypje dhe një pasqyrë për ta para atyre ndeshjeve. Besoj se do t’ia dalim në Ligën e Kombeve dhe të ngritemi në Grupin B. Tashmë veçse kemi filluar të përgatitemi dhe ndeshja ndaj Norvegjisë do të saktësojë shumë gjera”, ka thënë Foda, i cili ka treguar më pas se dëshironte t’i

ftonte dy futbollistë: Ismet Lushakun dhe Kreshnik Krasniqin, por që klubet e tyre nuk i kanë lejuar, derisa ka treguar se për arsye shëndetësore mungojnë Milot Rashica, Donat Rudhasni, Ismajl Beka dhe Mirind Kryeziu. “Ismet Lushakun dhe Kushtrim Krasniqin kisha dëshirë t’i ftoja, por ekipet e tyre nuk i lejuan pasi kampionati në Skandinavi është në zhvillim e sipër. Të gjithë

futbollistët e ftuar janë këtu, përveç Arjanet Muriq, i cili është i sëmurë. Jemi në kontakt dhe brenda dy ditësh do të dimë nëse do të jetë i gatshëm apo jo. Rudhani, Rashica, Kryeziu dhe Beka nuk janë ftuar për shkaqe shëndetësore”, ka shtuar Foda. Në fund përzgjedhësi Foda ka uruar edhe Ballkanin për titullin e kampionit si dhe Llapin, Dritën dhe Malishevën për kualifikim në

### Lista e futbollistëve

Arjanet Muriq, Visar Bekaj, Mustafë Abdullahu, Mwrgim Vojvoda, Florent Hadergjonaj, Amir Rrahmani, Ilir Krasniqi, Fidan Aliti, Lumbardh Dellova, Leart Paqarada, Valon Berisha, Blendi Idrizi, Liridon Emerllahu, Art Smakaj, Edon Zhegrova, Bernard Berisha, Altin Zeqiri, Drilon Hazrolaj, Ermal Krasniqi, Vedat Muriqi, Albion Rrahmani, Muhamet Hyseni, Elbasan Rashani.

## Asllani dhe Ajeti mezi e presin Evropianin: Emocion i veçantë, shkojmë për të bërë më të mirën tonë

**TIRANË, 30 MAJ** - Pas publikimit të listës paraprake për Kampionatin Evropian “Gjermani 2024”, kuqezinjtë kanë nisur përgatitjet me urdhrat e trajnerit Silvinjo dhe stafit teknik. Atmosfera brenda ekipit është shumë e mirë dhe të gjithë janë të gatshëm për ta dhënë maksimumin. Në një prononcim për fshf.org, Kristjan Asllani dhe Arlind Ajeti kanë treguar emocionet kuqezi në prag të finaleve të Kampionatit Evropian “Gjermani 2024”. Kristjan Asllani tregon se gjithmonë është një emocion i madh ftesa nga Kombëtarja dhe shton se po pret me padurim për



të luajtur ndeshjet e Evropianit, sidomos me Italinë. “Është një emocion i madh sa herë të thërret Kombëtarja shqiptare. Do shkojmë me shumë dëshirë për të luajtur ndeshjet, janë shumë të

bukura. Mezi po pres, sidomos ndeshjen e parë me Italinë. Ndjem shumë mirë. Ka qenë një sezon shumë i mirë për skuadrën dhe për mua, pasi kam marrë shumë minuta këtë vit. Tani

kemi ndeshjet dhe shpresoj që të paraqitemi sa më mirë”, ka thënë fillimisht mesfushori kuqezi, i cili shtoi se tifozët shqiptarë janë zjarr dhe mbështetja do të jetë maksimale edhe në Gjermani. “Emocionet janë vështirë të përshkruhen, por dua të them që sa herë më thërret Kombëtarja jam gjithmonë i lumtur. Evropiani është diçka shumë e veçantë dhe mezi presim që të fillojë. Kemi shumë lojtarë me cilësi dhe pothuajse të gjithë luajnë në ekipe të mëdha. Kjo mendoj që është diferenca nga viti 2016. Gjithsesi angazhimi, motivimi në Kombëtare është gjithmonë në

maksimum”, ka thënë fillimisht Arlind Ajeti, i cili pret edhe mbështetjen e tifozëve kuqezi në dy miqësoret ndaj Lihtenshtejnit (3 qershor në orën 20:00) dhe Azerbajxhanit (7 qershor në orën 19:00), në “Haladas Sportkomplexum”, Hungari. “Besoj që tifozët nuk kanë nevojë për thirrje, në çdo ndeshje na kanë ndihmuar dhe besoj që edhe në dy ndeshjet miqësore do të jenë pranë nesh. Çdo ndeshje do jetë speciale në Evropian, nuk mund të them Italia, Kroacia apo Spanja. Çdo ndeshje është speciale dhe do të bëjmë maksimumin”, ka përfunduar Ajeti.

## Rahoveci shkruan histori, fiton titullin e kampionit të Kosovës

**PEJË, 30 MAJ** - KH Rahoveci ka shkruar histori të mrekurën mbrëma. Për herë të parë skuadra rahovecase e ka fituar titullin e kampionit të Kosovës në hendboll. Në finale të plejofit, Rahoveci e mposhti skuadrën Besa Famgas. Ndeshja e dytë e serisë finale u zhvillua në

palestrën “Karagaçi” në Pejë në një ambient të bukur sportiv dhe para një numri të konsiderueshëm shikuesish. Rahovecasit e bënë shkëputjen e madhe që në pjesën e parë të cilën e fituan 21:11. Në pjesën e dytë vetëm kontrolluan lojën për festë të madhe në fund të saj.

Ndeshja përfundoi 29:24 në të mirë të Rahovecit. Rahoveci e kishte fituar finalen e parë me rezultat 34:30. Gjatë gjithë edicionit në kampionat e kishte vetëm një disfatë dhe të mrekurën kurorëzoi këtë dominim me titull historik të kampionit. Besa Famgas i kishte

dhjetë tituj rresht dhe i ka 19 gjithsej. Medaljet e argjenta për lojtarët e Besës i dhanë presidenti i FHK-së, Eugen Saraçini dhe kryetari i komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri. Ndërsa medaljet e arta për lojtarët e Rahovecit dhe kupën e



kampionit për kapitenin Ardian Osa, i dhanë presidenti Saraçini dhe kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi.



## Leclerc: Në xhirot e fundit rrezikova shumë, pasi garoja me sytë e mbushur me lot

**MARANELLO, 30 MAJ** - Piloti monogask Charles Leclerc theu tabunë ditën e diel, kur për herë të parë në karrierën e tij ai fitoi në garën e shtëpisë, atë në Montekarlo në Formula 1. Me makinën Ferrari ai pati një fundjavë të shkëlqyer, duke siguruar "pole position" ditën e shtunë dhe më pas dominoi e

fitoi ditën e diele. Duke rrëfyer emocionet e asaj gare, Leclerc kujton: "Nuk ka fjalë për të shpjeguar atë që ndjeva në ato momente. Aty e kisha nisur garën dy herë nga pole pa mundur të fitoj, ndaj kjo fitore e bën këtë sukses edhe më të veçantë. Këtu kam ëndërruar të bëhem një pilot i Formula 1,

ndaj është e vështirë në nivel emocional". "Në 15 xhirot e fundit shpresoja që asgjë të mos shkonte keq, sepse tashmë isha pothuajse i pushtuar nga emocionet. Mendoja pothuajse më shumë për babanë tim se sa për garën. Ai donte që unë të bëhesha pilot i Formula 1 dhe të fitoja këtë garë. Ishte e

bukur, me të vërtetë e veçantë, por edhe e vështirë", është shprehur Leclerc. "Dy xhirot e fundit, kur dola nga tuneli, u përpoqa të shihja sepse sytë më ishin turbulluar nga lotët. Kisha frikë se mos gaboja pikërisht në fund", kujton Leclerc. Monogasku i dhuroi kokoren e asaj garës ish-pilotit



Jules Bianchi, mik i tij i ndarë nga jeta disa vite më parë pas një aksidenti.

## Kosova barazon sërish në miqësore me Shqipërinë

**KUKËS, 30 MAJ** - Edhe përballja e dytë miqësore ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë është mbyllur në barazim. Por, për dallim nga ndeshja e tri ditëve më parë që nuk prodhoi gola, kësaj radhe të dyja ekipet kanë shënuar nga dy gola në ballafaqimin e zhvilluar në "Kukës Arena" (2-2). Ndeshja nisi më mirë për kombëtaren e Shqipërisë, e cila shënoi dy gola brenda dy minutave. Rezultatit e zhbllkoi Mattia Xhemaili, në minutën e 23-të, kurse epërsinë në 2-0 e shtoi Haxhi Rrena, në minutën e 25-të. Megjithatë, djelmoshat e Ilir Nallbanit shumë shpejt u këndellën me dy golat e Enes Pllanës. Fillimisht ai shënoi në minutën e 35-të, derisa në pjesën e dytë barazoi shifrat në minutën e 63-të (2-2), që në fund doli të jetë rezultati përfundimtar. "Sot ishte një



ndeshje shumë e mirë nga Kombëtarja jonë sepse futbollistët tanë ishin në nivelin e duhur dhe angazhimin e kanë pasur maksimal. Lojtarët i kanë zbatuar në përpikëri detyrat e

dhëna nga stafi, ashtu siç kemi kërkuar gjatë gjithë ndeshjes. Sikur të ishim pak më të kujdesshëm para portës do të mund edhe ta fitonim ndeshjen", ka thënë Nallbani.

## Broja: Në 'Euro 2024' mund të bëjmë diçka të veçantë

**TIRANË, 30 MAJ** - Më i lidhur se kurrë me vendin e tij, me rrënjët e tij. Në çdo dalje publike këtë periudhë, Armando Broja ka folur më fjalë të mëdha, me fjalë zemre për Shqipërinë, për tifozët kuqezi. Së fundmi, në një intervistë për revistën angleze, "Risingballers", bomberi shqiptar e nisi pikërisht nga tifozët, i bindur se me ta në krah, Shqipëria është me e fortë. "Tifozët e Shqipërisë janë më të mirët në botë. Ne jemi një trup i vetëm. Lojtarët, tifozët dhe vendi ynë të gjithë së bashku kemi", nis rrëfimin e tij Broja duke u ndalur më pas tek mënyra e tij e festimit, ku në Angli e lidhin me një imitim ndaj Anelkas, ish-sulmuesi i Chelsea, por Broja e përsëriti se festa e tij ka lidhje me simbolin e vendit të tij, shqiponjën: "Kur shënoj festoj duke bërë shqiponjën. Të gjithë mendojnë se



imitoj Anelkanë, por unë festoj sepse dashuroj vendin tim. Është një mënyrë festimi unike". Sulmuesi shqiptar u pyet edhe në lidhje me "Euro 2024", ftesën e marrë nga Sylvinho dhe grupin ku bën pjesë Shqipëria. "Do të jetë një emocion i madh për mua. Dua të

falënderoj edhe familjen pasi më ka mbështetur gjithmonë. Të gjithë e dimë se jemi në një grup të fortë, mbase më i vështiri në Evropian, por ne mund të shkojmë në Gjermani dhe mund të bëjmë diçka të veçantë", u shpreh Broja.

### SHKURT

#### Roland Garros: Swiatek i 'shpëton' eliminimit, avancojnë Alvaraz, Sinner e Tsitsipas

Ka nisur raundi i dytë i grand slam të Roland Garros, ku emocionet nuk kanë munguar. Numri 1 në botë për femra, Iga Swiatek, rrezikoi eliminimin në përballjen ndaj japonezes Naomi Osaka. Swiatek fitoi 2-1 (7-6, 1-6, 7-5), pasi anuloi një "match point" të rivales në setin e tretë. Në raundin e dytë avancojnë edhe tenisja amerikane Cori Gauff, që mundi 2-0 Tamara Zidansek. Një biletë për më tej sigurojnë edhe Sofia Kenin e Ons Jabeur. Te meshkujt, fitore e vuajtur për spanjollin Carlos Alcaraz, që fitoi 3-1 (6-3, 6-4, 2-6, 6-2) ndaj Jesper de Jong. Në raundin e tretë avancojnë edhe italianin Jannik Sinner, numri 2 në botë, që mundi 3-0 (6-4, 6-2, 6-4) Richard Gasquet. Fitore e vështirë edhe për grekun Stefanos Tsitsipas, që mundi 3-1 Daniel Altmaier, ndërsa rusi Andrey Rubel eliminoi Pedro Martinez. Në raundin e tretë shkon edhe Pavel Kotov.

#### Mbappe: Ekipi im i ardhshëm do të zyrtarizohet shpejt, mezi po pres

Kylian Mbappe do të bëhet me skuadër të re në ditët në vijim. Ylli francez u largua nga Paris Saint-Germain dhe po raportohet fuqishëm se ai do të kalojë te ekipi i tij i ëndrrave, Real Madridi. Vet Mbappe foli rreth të ardhmes duke thënë se klubi i tij i ardhshëm do të zyrtarizohet së shpejti, por nuk përmendi emrin. "Ekipi im i ardhshëm do të zyrtarizohet shpejt, është çështje ditësh. Mezi po pres, jam i lumtur. Duhet vetëm të presim për disa ditë", ka thënë Mbappe.

#### Benzema pritet të rikthehet në Evropë

Karim Benzema do të largohet nga Arabia Saudite vetëm pas një viti qëndrimi te skuadra Al Ittihad. Sulmuesi francez ka kontratë me klubin saudit edhe për dy vite, por ai nuk është i lumtur në Lindjen e Mesme pasi ka pasur probleme me klubin dhe trajnerin. Përkundër se ka luajtur në 33 ndeshje në të gjitha garat duke shënuar 16 gola, Benzema nuk dëshiron të mbetet në elitën e futbollit arab. Gjiganti turk Fenerbahçe po tenton ta bind francezin për tu rikthyer në Evropë dhe për këtë ka nisur kontaktet e para me menaxherin e tij. Sipas gazetës turke "Aksam News", ekziston një mundësi e madhe që Benzema t'i bashkohet klubit turk. Ky transferim i mundshëm varet nga rezultati i zgjedhjeve të klubit, me bordin e Ali Koçit që është çelësi për të siguruar nënshkrimin e Benzemas. Megjithatë skuadra turke nuk dëshiron që të paguaj më shumë se 15 milionë euro për transferimin e tij nga Al Ittihad dhe mbetet të shihet nëse klubi arab do ta lejoj largimin e francezit.

## Moratti entuziazmon tifozët zikaltër: Mund të rikthehem në krye të Interit

Massimo Moratti ndez edhe më shumë entuziazmin e tifozëve të Interit. Në ditët e nxehtat të kalimit të pronësisë së klubit zikaltër nga grupi kinez Suning te fondi amerikan Oaktree, ish-presidenti pasionant ka deklaruar se po merr në konsideratë rikthimin në krye të Interit. Në një intervistë për

median italiane Moratti pranoi se kostot janë rritur ndjeshëm dhe se është e vështirë që ta mbajë i vetëm skuadrën në nivele të larta, megjithatë la të hapur mundësinë e blerjes së shumicës së aksioneve të klubit. "Rikthimi tek Interi nuk është i lehtë, por nuk mund ta përjashtoj si mundësi. Gruaja ime

më pyet çdo natë nëse e kam blerë klubin dhe unë duhet të gjej justifikime. Jemi shumë të lidhur me klubin dhe sigurisht që nuk përjashtohet blerja e aksioneve. Megjithatë kostot janë rritur shumë dhe është thuajse e pamundur që një person i vetëm të mbajë një klub si Interi në nivele

të larta. Një president tifoz është shumë e vështirë t'ia dalë në ditët e sotme. Edhe Reali i Madridit është i mbytur në borxhe", u shpreh Moratti. Ish-presidenti legjendar, i cili u dha zikaltërve edhe Ligën e Kampionëve për herë të fundit në 2010-ën komentoi edhe kalimin e pronësisë te grupi amerikan

Oaktree. "Ata janë një fond shumë solid, por borxhet e klubit janë të larta dhe do të synojnë t'i ulin. Është gati e pamundur që të mbash një skuadër konkurruese, pa prishur bilancin ekonomik të klubit, ndaj jam kurioz të shoh qasjen e Oaktree në këtë aspekt", ka shtuar Moratti.





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**Kuvendi i Republikës së Kosovës, shpall:**

**K O N K U R S**

**Për zgjedhjen e 7 (shtatë) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore**

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 4.8 të Ligjit nr.02/L-88 për Trashëgimi Kulturore, dhe me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore (KKTK), shpall konkurs për zgjedhjen e 7 (shtatë) anëtarëve.

**Përbërja e KKTK-së**

KKTK përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, të cilët zgjedhën për një mandat 3 (tre) vjeçar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, duke respektuar përbërjen etnike në Kosovë.

**Funksionet e KKTK-së:**

- Vlerëson dhe shpall trashëgiminë kulturore në mbrojtje të përhershme;
- Vlerëson të gjitha projektet e trashëgimisë kulturore të parashtruara nga institucionet e fushave përkatëse;
- Identifikon masat e domosdoshme të mbështetjes financiare për trashëgimi kulturore;
- Vlerëson të gjitha asetet më rastin e shpronësimit dhe shitblerjeve.

**Kandidati/ja për t'u zgjedhur anëtar i KKTK-së duhet t'i plotësojë këto kushte:**

- Të jetë shtetas dhe banor i përhershëm i Republikës së Kosovës;
- Të ketë etikë të lartë profesionale;
- Të ketë së paku diplomë universitare 4 (katër) vjeçare ose Mastër, në fushën e trashëgimisë kulturore, fushës së arteve, arkeologjisë, arkitekturës, historisë, sociologjisë, etnologjisë dhe antropologjisë kulturore;
- Të ketë së paku 7 (shtatë) vite përvojë pune profesionale në fushën e trashëgimisë kulturore;
- Kandidatët që kanë botime, publikime, aktivitete në fushën e trashëgimisë kulturore kanë përparësi;
- Të jetë njohës i legjislacionit në fuqi për trashëgimi kulturore, si dhe konventave ndërkombëtare;
- Të mos jetë i dënuar për vepër penale, të dënueshme mbi 6 (gjashtë) muaj,
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi.

**Mandati i anëtarëve të Këshillit**

- Anëtarët e KKTK-së zgjedhën për mandat 3 (tre) vjeçar.

**Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:**

- Aplikacionin;
- Autobiografia (Curriculum Vitae);
- Letër motivuese;
- Dy referenca,
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale;
- Dëshmia për përvojën e punës;
- Dëshmia se nuk është nën hetime ose i dënuar për ndonjë vepër penale.

**PROCEDURA E KONKURRIMIT**

**Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më 14 qershor 2024, në orën 16:00.**

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën: Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtoria për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Zyra N-217).

**Aplikacionet mund të merren në këto vende:**

**Forma e shtypur:** në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose

**Forma elektronike:** faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës

[www.assembly-kosova.org](http://www.assembly-kosova.org)

Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038 200-10411, 038 200-10410 dhe 044 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara. Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, konsiderohet i pavlefshëm.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**Skupština Republike Kosova raspisuje:**

**K O N K U R S**

**Za izbor 7 (sedam) članova Saveta Kosova za kulturno nasleđe**

Skupština Republike Kosovo, na osnovu člana 4.8 Zakona br. 02/L-88 o Kulturnom nasleđu i u cilju ispunjavanja zakonskih obaveza za izbor članova Saveta Kosova za kulturno nasleđe (SKKN), raspisuje konkurs za izbor sedam (7) članova.

**Sastav SKKN**

SKKN je u sastavu od 7 (sedam) članova, koji se biraju sa mandatom od 3 (tri) godine od strane Skupštine Republike Kosovo, poštujući etnički sastav na Kosovu.

**Funkcija SKKN:**

- Ocenjuje i objavljuje kulturno nasleđe u stalnoj zaštiti;
- Ocenjuje sve projekte kulturnog nasleđa, koje podnose institucije dotičnih oblasti;
- Identifikuje neophodne mere finansijske podrške za kulturno nasleđe;
- Ocenjuje sve asete, prilikom eksproprijacije i kupoprodaje.

**Kandidat za izbor člana SKKN dužan je da ispuni sledeće uslove:**

- Da bude državljanin i stalni stanovnik Republike Kosova;
- Da poseduje visoku profesionalnu etiku;
- Da ima najmanje 4 (četiri) - godišnju univerzitetsku diplomu ili Master u oblasti kulturnog nasleđa, oblasti umetnosti, arheologije, arhitekture, istorije, sociologije, etnologije i kulturne antropologije;
- Da ima najmanje 7 (sedam) godina profesionalnog radnog iskustva u oblasti kulturne nasleđa;
- Kandidati koji imaju publikacije i drugi aktivnosti u oblasti kulturnog nasleđa imaju prioritet;
- Da je poznavalac zakonodavstva na snazi o kulturnom nasleđu, kao i međunarodnih konvencija;
- Da nije kažnjavan za krivično delo, kažnjivo više od 6 (šest) meseci;
- Poznavanje stranih jezika je prednost.

**Mandat članova Saveta**

- Članovi SKKN biraju se sa mandatom od 3 (tri) godine.

**Aplikaciji mora da se prilože sledeći prateći dokumenti:**

- Aplikacija;
- Autobiografija (Curriculum Vitae);
- Motivaciono pismo;
- Dve reference;
- Dokaz da je državljanin Republike Kosova;
- Dokaz o školskoj i stručnoj spremi;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Dokaz da nije pod istragom ili kažnjavan za krivično delo.

**PROCEDURA KONKURISANJA**

**Aplikacije se dostavljaju najkasnije do 14. jun 2024. godine u 16.00 časova.**

Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu: Zgrada Skupštine Republike Kosova, Priština (Ul. „Majka Tereza“ bb., Direkcija za upravljanje ljudskim resursima, Kancelarija N-217).

**Aplikacije se mogu uzeti u ova mesta:**

**Štampana forma:** u recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosova, Priština, ul. „Majka Tereza“ bb. ili u

**Elektronskom obliku:** internet-stranica Skupštine Republike Kosova –

[www.assembly-kosova.org](http://www.assembly-kosova.org)

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana u 16:00 časova, na brojeve telefona: 038 200-10411, 038 200-10410 dhe 044 567-041.

Aplikaciju treba dostaviti uz tražena dokumenta. Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažecim.









**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992









## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

